

Fejz DEMIRI  
NË DETIN E DASHURISË E TË THËNIES  
Fjalë të urta dhe mendime autoriale

Redaktimi letrar e gjuhësor  
Prend BUZHALA

Kopertina  
Kushtrim ZENUNI

Shtypshkronja

Fejz DEMIRI

NË DETIN E DASHURISË  
E TË THËNIËS

Fjalë të urta dhe mendime autoriale

Shtëpia Botuese

Prishtinë

2015

3



1. Edukata e bën njeriun të veçohet nga të tjerët.
2. Shtëpia, sado e ngrohtë që është, pa anëtarët e familjes është e ftohtë.
3. Sikur zogu që e do folenë, edhe njeriu e do atdhenë.
4. Atdheu është vatër e zjarrtë, që na djeg në shpirt.
5. Lumturoji familjen që të jesh ti i lumtur.
6. Falja e vë shpirtin në qetësi.
7. Njeriu çdo ditë vdes nga pak.
8. Një gjë e bukur të krijon ndjesi shpirtërore.
9. Më e lumtura e lumturisë, është buzëqeshja e fëmijës.
10. Më e shëmtuara e shëmtisë, është loti i ngrirë i fëmijës.
11. Shtëpia pa zot shtëpie, është si shtëpia pa bukë.
12. Njeriu duhet të jetë i denjë për t'u nderuar e respektuar.

13. Zemrat e buta përjetojnë dhimbjen më të madhe.
14. I suksesshëm është ai që e fiton bukën me djersën e ballit.
15. Lisi i madh, e hija e vogël.
16. Kur nuk di, në të mos hi.
17. I mirë është ai që njihet në sprovë të vështirë.
18. Guri i kuq në tjegulla të bardha.
19. Njeriun e turpëron lakmia.
20. Oda e mirë e do plakun.
21. E mira as në det nuk fundoset, rri në krye.
22. Më e rëndë fjala se dhuna.
23. Me dy lopata (kacia) s'bëhet shtëpia.
24. Çdo kush sot është mik, po bëhet akademik.
25. Njeriu jeton me u lavdue.
26. Mësojmë duke mësuar.
27. E mira nuk hidhet në ujë.
28. Mos e hidh qumështin asnjëherë mbi dardha.
29. Nder i bëhet fqinjit të mirë.
30. Dyluftimi e shfaq epërsinë.
31. Fara në arën e huaj është e humbur.
32. Topi gjuhet, aty ku ti e hedh.

33. Në tokën e huaj dheu është i lehtë, kurse në tokën mëmë guri peshon rëndë.
34. Mos e vrit njeriun me fjalë të rëndë.
35. Duart e gjata, gishtërinjtë e vegjël.
36. I ftohti dhe i nxehti janë vëllezër.
37. Mysafiri i keq i shti në fesat gjithë familjen.
38. Burrëria e ka burrërinë...Besnikëria e ka besën.
39. Nëse jeni optimist, ju mund të arrin.
40. Të kuptosh do të thotë se çka është e drejtë.
41. Suksesi më i madh, kur je i suksesshëm.
42. Besimi të dërgon në arritje.
43. Jeta është e bukur kur kalon në lumturi, jeta është e vrazhdë kur kalon në zi.
44. E vërteta nuk thuhet ndryshe, veçse qysh qëndron.
45. Mos u bëj më i keq se i keqi.
46. Fitoret rrjedhin nga zemra.
47. Koha me këmbë po na kalon.
48. I ati punëtor, i biri dembel.
49. Çdo kujt s'i buzëqesh fati.
50. Fjala e ëmbël zemrën ta pastron, fjala e hidhët të shkrumbon.
51. Puno që varfëria të zvogëlohet, o mik....
52. Mëso, që padituria të largohet...

53. Një gjë e mirë, mund edhe të harrohet... kurse një ngjarje e hidhët mbetet përherë në kujtesën tonë.
54. Kultura është hap i së drejtës.
55. Njerëzit e përçmojnë atë, që për ta nuk është e rëndësishme.
56. Mos lakmoni në pasuri, buka e kripa janë në shtëpi.
57. Fatkeqësia e sprovon njeriun.
58. Nuk është njerëzi të fyesh fëmijën.
59. Nuk është burrëri të rrahësh gruan.
60. Nuk është burrëri të vritemi ndër vete, burrëri është ta mbrojmë atdheun tokën stërgjyshore.
61. Jeta vazhdon me brenga dhe arrin majat.
62. Vuajtjen e mposht puna.
63. Më e çmuara e një njeriu është morali i mirë.
64. Drejtësia është një shpellë e fortë që nuk shembet kurrë.
65. Maturia është karakteri më i fortë i një njeriu.
66. Nganjëherë sa më shumë mundohesh për mirë...gjërat shkojnë edhe më keq.
67. Nuk bëhet rrushi pa vreshta.



68. Ndërgjegjja mpreh shpirtin.
69. Arsyja buron nga mëkatari.
70. E bukura më së miri kuptohet nga shpirti i pastër.
71. Vepra e një politikani është fjala.
72. Ne arrijmë ti krehim flokët, por asnjëherë nuk arrijmë ta krehim shpirtin.
73. E bukura është qëllimi më i madh i shijes.
74. Fjala e rëndë pëlcet dhe gurin.
75. Gjërat që na duken më të lehtat, janë më të vështirat.
76. Vogëlushi zhvillohet si një barrë, mbi supet e dikujt.
77. Dashuria për prindërit dhe familjen, është detyrim moral dhe njerëzor.
78. Përsosuria e një shoqërie nis nga familja.
79. Nëse familja nuk është e ndërtuar me parime edukative, as fëmija nuk mendohet të jetë me edukatë.
80. Nuk ngopet njeriu me një kokërr oriz.
81. Dituria e urtia janë arma më e fortë e njeriut.
82. Bëhu që ti ta pish alkoolin, e jo alkooli ty.
83. Tradhtia vret pas shpine.
84. I ikuri është i humbur.

85. Qeni jeton aty ku ushqehet.
86. Mos e kap dardhën në bisht, se këputet.
87. Nuk fitojnë e shtrembëta e gënjeshttra, por e drejta dhe e sinqerta.
88. Mos kalo nëpër ferra, se të futen në këmbë.
89. Barku është si deti... nuk ngopet me të ngrënë e me të pirë.
90. S'ndalet zjarri me këmbë, por me ujë.
91. Edhe nëse di një punë mirë ta zotërosh, e kotë nëse s'i ke mjetet ta punosh.
92. Arrat e mëdha i kanë thelpinjtë e vegjël.
93. Bunari i thellë është më i pastër.
94. Sa më shpesh hunjtë, gardhi edhe më i fortë.
95. I ligu fshihet pas cingu.
96. Qeshja të jep përplot vetëbesim.
97. Një gjë e bukur nuk është e shëmtuar, kurse një gjë e shëmtuar nuk mund të jetë e bukur.
98. Ushtari e fiton betejën e jo ushtria.
99. Gjithçkaja nuk është gjithçka.
100. Çdo dyshim duhet kapërcyer.
101. Mos u merr asnjëherë me brengat e së kaluarës.
102. Gjërat e veçanta mbesin përherë në ekranin e vetëdijes.

103. Fëmijëria është pjesa më e bukur e jetës... ajo lë gjurmë të pashlyera në kujtesë.
104. Shoqëria e keqe të nxit të merresh me punë të liga.
105. Pengesë është ajo që nuk mund ta pengojmë.
106. Njeriu nuk mund të jetojë, nëse liria e tij cenohet tërësisht.
107. E rëndësishme për një njeri, është ta ruajë dhe ta mbrojë dinjitetin e tij.
108. Më i rëndë fukarallëku se pleqëria.
109. Nëse për një punë ke vullnet, puna kryhet me shumë sukses.
110. Njeriu duhet të luftojë që ta ngrisë nivelin kulturor e arsimor.
111. Aktivitetet e njeriut janë ushqimi shpirtëror i tij.
112. Pa zemërim dhe inat, jeta duket shumë bajat.
113. Pas shumë përplasjeve, prapë vazhdon lumturia.
114. Koha të mëson zakone të mira dhe të këqija.
115. Koha e mëson shpirtin të falë.

116. Teknologjia në avancim, bota po shkon nga shkatërrimi.
117. Paratë nuk mund ta pasurojnë shpirtin.
118. Ndalo duhanin, shpëto shëndetin.
119. Lufta është kurorë e sakrificave dhe mundimeve.
120. I shëmtuar është ai, i cili ka vepra të këqija dhe mendjen e keqe.
121. Motrat i afrojnë më shumë baxhanakët, që të duhen ndër vete.
122. Mos e ngarko trurin më tepër se ç'duhet.
123. I varfëri është i pasur, sepse jep edhe atë që ka.
124. Koha kalon me kalimin e kohës.
125. Nuk është me rëndësi kush mori, por kush u zu duke marrë.
126. Njeriu kur krijon, edhe shkatërron.
127. Edhe ekipi më i fortë e ka lojtarin e dobët.
128. Nuk duhet qitur ujin në shoshë.
129. Pas së vështirës vjen më e mira.
130. Bota është shumë e vogël për njeriun.
131. Njeriu e zotëron botën, e jo bota njeriun.
132. I guximshëm është ai që i del para problemit, e jo ai që fshihet pas tij.
133. Asnjëherë njeriu nuk ngopet nga dëshirat.

134. Nëse dëshiron cilësi, duhet të punosh me kujdes.
135. Lumit asnjëherë s'i ndalet burimi.
136. Përvoja e mëson njeriun si duhet jetuar.
137. Ndonjëherë njeriu, duhet të ketë inat edhe nga vetja e tij.
138. Nuk sjell gjithmonë jeta shpërblime.
139. Asnjëherë mos u kënaq me suksesin që ke arritur, gjithnjë kërko më shumë nga vetja.
140. Gjithnjë nga të këqijat mundohemi ta nxjerrim një të mire.
141. Çdo herë njeriu duhet ta gjejë rehatinë shpirtërore.
142. Njeriu i pa ditur, është si njeriu i egjër.
143. Fytyra e zezë s'pastrohet dot.
144. Të fortit e të guximshmit nuk i buzëqesh çdo herë fati.
145. Interesante është ajo gjë... që jemi të interesuar për të!
146. Hakun fale, inatin mbaje.
147. Kur bën mirë, e duron të keqen më shumë.
148. Dobësia ime është fuqia jote.
149. Mplaket trupi, por jo mendja.
150. E mira nuk ka fund, e keqja e ka fundin.
151. Shakaja nuk bëhet në çdo kohë.

152. Njeriu dallohet nga puna.
153. Nëse fitimi mes dy personave ndahet, keq ajo punë vajti për dreq.
154. Hidhërimi mpreh shpirtin.
155. Kur ta konsumosh darkën e lehtë, dhe gjumi të zë qetë.
156. Më mirë ndonjëherë të harroj, se veçse të këqija të kujtoj.
157. Gjërat duhen me rend, në kohë dhe vend.
158. Kur dëshiron fitim, ndonjëherë duhet dhe humbje.
159. Më i rëndë maskarallëku se fukarallëku.
160. Zemër e gjakosur, zemër e kulluar asnjëherë e gëzuar.
162. Syri trembet, krahu s'trembet.
163. Më shumë bën mendja, se sa forca.
164. Hidhërimi të djeg më shumë se rakia.
165. E djeshmja nuk është si e sotmja, e sotmja nuk mund të jetë si e nesërmja.
166. Fol, Ali, çka tha Rama! Fol, Ramë, çka tha Aliu!
167. Mos prit nga tjetri.
168. Kafsha rehatinë më të madhe e gjen në strofullin e vet.

169. S'bën që vetë të shkruash e vetë të vulosësh.
170. Nga shumë gëzime del hidhërimi... nga shumë hidhërimë del gëzimi.
171. Aq më shumë punë të mira që bën njeriu, përmendet çdo herë në odë e në kuvend.
172. Faji bëhet nga çdo njeri, në rini e pleqëri.
173. Dridhet shelgu e jo bungu.
174. Puna çdo herë e ka faqen e bardhë, dembelia faqen e zezë.
175. Bukuria nuk zgjat gjithmonë, dituria çdo herë qëndron.
176. Vesi i keq, deri sa të vdesë.
177. Burrin e qartë gruaja..
178. E mira vjen ngadalë, e keqja sa hap e mbyll sytë.
179. Më mirë ndarja, se çdo ditë përçarja.
180. Kur vjen pleqëria, humb fuqia... rrudhohet fytyra.
181. Mendja dëgjon dhe gjykon.
182. Nuk e ha qeni qepën.
183. Moti është në anën e punëtorit.
184. Kur s'ke punë, hiqi bajgat nga livadhi.
185. Punësimi është jorgani i të varfërve.
186. Miqësia e tepërt shpie në armiqësi.

187. Uji del i kulluar, rrugës bëhet i turbulluar.  
Edhe njeriu lind i urtë, por kur rritet mund të bëhet shumë i egjër.
188. Muhabeti- lum për veti.
189. Një e ligë s'paguhet me dhjetë të mira.
190. Fajit s'i del askush para.
191. Nëse je i ditur, je i fituar.
192. Pasuria nuk është çdo herë lumturia.
193. Marrëzirat e njeriut i kanë rrënjët thellë.
194. Lëvdatat e rreme nuk të dërgojnë askund.
195. Lisat janë të gjatë, por rrënjët i kanë thellë në tokë.
196. Vdekja i bashkon njerëzit, që janë të hasmëruar ndër vete.
197. Të dhurosh nga zemra, është bujari.
198. Dinakëria e shpie në kurth hasmin.
199. Njeriun e komandon shëndeti.
200. Bukë, djathë, qumësht e ko - shëndet plot.
201. Dembeli i do gjërat të gatshme.
202. Njeriu vuan për njeri.
203. Nga miqësia largohet mërzia.
204. Dashuria flet në shpirt.
205. Çdo kujt dikush i fle në shpirt.
206. Dhelpra vjen me dinakëri, ujku me trimëri.
207. Duke ndërtuar mos prish.



208. Mos i shit rrush vreshtari, se ka sa të duash.
209. Gjysma e gjysmës prapë mbetet gjysmë.
210. Malli djeg shpirtin, si qiriu në errësirë.
211. Te plaku mbretëron dyshimi.
212. Më e rëndë është plaga e fjalëve të rënda...se sa e plumbit.
213. Druri i shtrembër nuk drejtohet, fjala e keqe s'kthehet pas.
214. Shtatin lis, mendjen pis.
215. Lum ai njeri, që jeton me djersë të tij.
216. Bima duket me të mbirë.
217. Bukë, djathë e rahat.
218. Duaje atë që të do...respektoje atë që të respekton.
219. Qeshja e madhe, shëndeti pa masë.
220. Nuk është trim ai njeri, që lufton me vëllanë e tij.
221. Peshkut të brishtë i vjen era.
222. U bë shtëpia, u rrit fëmija.
223. U lag toka, mbiu fara.
224. Njeriu plaket, shpirti nuk plaket.
225. Fjala e ndershme të nderon, fjala e hidhët të poshtëron.
226. Plagët e shpirtit, s'shërohen lehtë.

227. Buzëqeshja zgjat jetën, mërzia e shkurton atë.
228. I humburi të humb.
229. Fshati ka zanat.
230. Dashuria ndaj krijuesit dhe familjes...duhet të jetë e shenjtë.
231. Mendimet pozitive sjellin kthesa.
232. Edhe dje edhe sot, duaje atë që për ty derdh lot.
233. Qaj pa të rrahur.
234. Ditë e re, sprovë e re.
235. Gjërat që t'i ka dhuruar dikush, mos i dhuro.
236. Puna e mirë, s'duhet ndyrë.
237. Uria të shpie të merresh me punë të liga.
238. Dita –ditës nuk i ngjason.
239. Ruaju çdo herë nga të ligat.
240. E keqja lahet me të mirë, e jo me të keqe.
241. Shtatgjati nuk bëhet shtatshkurtër.
242. Dëgjo dhe gjyko.
243. Mos të daltë nami i keq në pazar.
244. Ai që punon, hesht.
245. E bukura shfaqet për ditë, dhe në çdo kohë.
246. Çdo kush dikujt i fle në zemër..

247. Nuk jetohet me djersën e të tjerëve.
248. S'i bëhet nder të keqit, se bëhesh edhe më i keq se ai.
249. Njerëzit e vjetër japin këshilla të mira.
250. Goja bluan fjalë të mira dhe të këqija.
251. Mos u prish me vëllanë...për shoqëri.
252. Mos e pi rakinë...se ta shkatërron mëlçinë.
253. Kush nuk punon, për të voglën...nuk mund ta fitojë as të madhen..
254. Mos bie... për hiq gjë.
255. Nëse dëshiron sukses, duhet të kesh përkushtim.
256. Nëma më e madhe për një njeri, është kur i thua :''Mbetsh pa punë''.
257. Të mban lëngu yt, e jo pitja e huaj.
258. Pas shtatorit nuk vjen prapë korriku..
259. I fortë është ai që përmbahet nga zemërimi.
260. Kur mundemi- nuk dimë, kur dimë - nuk mundemi.
261. Njeriu e bën emrin, emri s'e bën njeriun.
262. Njeriu ndihet keq kur zihet me persona që për atë janë të rëndësishëm.
263. Fjala e egër djeg zemrën, fjala e ëmbël zbut zemrën.

264. Njeriu pa miq, është i vdekur.
265. Miku shumë lehtë bëhet armik, kurse armiku i vjetër vështirë bëhet mik.
266. Përvoja vret dinakërinë.
267. Ndonjëherë më e mirë vetmia, se sa e keqe shoqëria.
268. Qeni ku ha bukën - leh.
269. Kodrat e mëdha përbëhen nga gurët e vegjël.
270. Mos u bëj trim i pluhurit.
271. Budalla të vret me budallallëk.
272. Njeriu ushqehet me bisedë.
273. Biseda është ushqimi shpirtëror i njeriut..
274. Lum ai që e bën armikun mik.
275. Mos ke frikë nga ai që ty ta ka frikën.
276. Dikush fshihet pas gjethit e nuk hetohet, kurse dikush fshihet pas drunjve dhe hetohet.
277. Gjëja e vjedhur është e vjellur.
278. Një fjalë e ëmbël nuk kushton asgjë, por vlen më shumë se çdo gjë.
279. Respekti u bëhet njerëzve të merituar.
280. Grave u ka hije vallëzimi, burrave durimi.
281. Punët në grupe janë më efikase, se ato individuale.
282. Nëse do fitim, duhet rrezikim..

283. Lotët e shpirtit janë lajmëtarë të një dashurie të papërshkrueshme.
284. Çdo mundim gjen shpërblim.
285. Puno ditën, që të pushosh natën.
286. Nuk ka gjë më të rëndë, se humbja e njerëzve të mirë.
287. Më mirë të jetosh 50 vite e në lumturi, se 70 vite e në zi.
288. Çika për zemër, djali për emër.
289. As për vaj, as për gaz.
290. Familja është ajoqë të bën të ecësh përpara.
291. Zhurma e detit, qetësia shpirtërore e ime.
292. Kur ke shumë veprime, ndodhin keqkuptime.
293. Lodhet, ende pa ia filluar punës.
294. Miku s'blihet me para.
295. Çdo kush ka veçantinë e tij.
296. Veprat e këqija duhet të largohen, të shkatërrohen sikurse zjarri që i djeg drutë.
297. Besimi i tepruar kalon në mosbesim.
298. Mos i fshij duart për murriz.
299. Lidhu me tëndin, njësoj si zinxhir.
300. Prej të marrit largohu, ngatë të mirit afrohu.

301. Njerëzit që nderojnë, duhet nderuar.
302. Nëse shkon pas të mençurit, gjithnjë do ta kesh rrugën e ndriçuar.
303. Të kesh gruan e ndershme, është pasuri....
304. Thashethemet i bëjnë dëm njeriut (njerëzimit).
305. Mos hyr borxh, te e keqja.
306. Mos u bëj bujar me mall të huaj.
307. I marri bën veç marrëzira.
308. Njeriu vdes nga inati.
309. Pleqve, nuk iu pëlqen nxitimi, por durimi.
310. Është me takat, por dhe me fat.
311. Kur s'ke lopë, do të hash pulë.
312. Sa lehtë, aq vështirë.
313. Shumë pika uji -pëlçet dhe guri.
314. Budallai ta këputur zinxhirin më të trashë,i mençuri as perin më të hollë.
315. Mos u prish me vllazni, se e prish një farefisni.
316. Puna nuk e lodh njeriun, nëse atë e bën me shumë vullnet.
317. Mospunësimi- ngushtimi.
318. Toka e mirë –miell.
319. Puna e mëson njeriun, se si duhet punuar.
320. Siç e nisi, e bitisi.

321. Thuaj fjalë të mira, o njeri.
322. Realitetit jepi përparësi, thuaje të vërtetën, çdo kush ta ketë lakmi.....
323. Mos eja si ujku n'mal.
324. Mos u bëj njeri i vobektë.
325. Veç të kesh dhen, bari gjen sa të duash.
326. Pasuria i përket atij që arrin ta gëzojë.
327. Ku ka piper, aty ka shije.
328. E keqja largohet, e mira dyfishohet.
329. Harrimi është pluhur i trashë i të ligës dhe i vdekjes.
330. Kushëri, e zotni.
331. Ai që nuk do të vijë, gjithnjë e gjen një arsye.
332. Njeri i fortë është ai që ka besë e burrëri.
333. Njeriun të fortë e bën besa e burrëria, e jo ligjësia, turpësia e pafytyrësia.
334. Ma inati, se inati.
335. E hapi njëri, të tjerët vijnë pas.
336. Kur s'dëshiron të ma japësh, si ta kërkoj.
337. Qysh s'ke turp të turpërohesh.
338. Mos u bëj pesë herë gomar.
339. S'them nga turpi, por nga mendja.
340. I mençur është ai që është ekonomist i familjes.

341. Defi i mirë të shti me kërcye.
342. S'prehet livadhi me gërshërë.
343. Prej meje shëndosh, prej teje sakat.
344. Çdo ditë koha kalon, por gjërat nuk i ndryshon.
345. Më i zhgënjyer se zhgënjyesi.
346. S'ndalet plumbi me dorë.
347. Më mirë pak të punosh e të pushosh, se veç të pushosh e mos të punosh.
348. Puna e kënaq njeriun.
349. Puna e mirë njeriun e zbukuron, prej vesit të keq përnjëmend e largon.
350. Mos e harro dëshirën e parë dhe shuplakën e fundit.
351. Nëse një punë e bën pa detyrim, e bën vetë, ajo punë kryhet me sukses, sepse ke vullnet.
352. Vullneti i madh e dërgon njeriun në arritje të lartë.
353. Kur njeriu është i lexuar, bëhet më i arrirë dhe është i fituar.
354. Fitoi Fator Fituesi.
355. Mos kërce si gështenja n'zjarr.
356. Me tëndin lidhu, me armik zgjidhu.



357. Mos e zhgënje atë njeri, që krejt të vërtetat t'i tregon ty.
358. Nëse je i drejtë, pse hyn nëpër kthesa.
359. Durimi sjell fitimin, ngutja trishtimin.
400. Po s'hyre në baltë, s'mund të fitosh mjaltë.
401. Çdo njeri ka nga një hall, por mjer ai njeri që ka hall mbi hall.
402. Nga pakica bëhet shumica.
403. Jeto, puno, duro, guxo, lufto....
404. Frikësimi-trishtimi.
405. S'ka gjë më të shtrenjtë se të kesh harmoni në familje,
406. Shumë mendime sjellin një mendim.
407. Shëndosh jemi, Zoti i madh, gjërat e tjera vijnë dal –ngadalë.
408. Në ditët e sotme tek njerëzit mbretëron inati.
409. Çdo njeri mundohet të shikojë kënaqësitë e tij.
410. Mos lakmoni në dembelizëm.
411. Mos të të pajtojë e keqja, por më e mira.
412. Më mirë me ruejtë, sesa me gjuejtë.
413. Më lehtë me ruejtë, se sa me e gjuejtë.
414. Punë, punë natë e ditë edhe bukën ta pjekim për dritë.

415. Fukara e me lezet, i pasur përplot dert.
416. Njeriu krijon zakone.
417. Vjehrra kujton kohën e nusërisë.
418. S'bëhet dasmë me 50 vetë.
419. Me fjalë të mira ndreqet muhabeti.
420. Me fjalë të këqija prishet ndeja.
421. I ndyti çdo herë përdor fjalë të ndyra.
422. Ndonjëherë mjaft nuk është mjaft.
423. Lehtë është ta vësh zjarrin, e vështirë është ta shuash atë.
424. Fëmija është fryt i familjes.
425. Sa gëzueshëm, aq idhnueshëm.
426. Kur s'dëgjohet më i vjetri, mjerë për atë shtëpi çka e gjeti.
427. Shtëpia do rregull, ujku mjegull.
428. Prej një fëmije të mbarë gëzohet katundi, prej një fëmije të keq mbaron katundi.
429. Edhe nëse i ke fjalët e hidhëta, punët bëji të mira.
430. Mos thuaj ndryshe, por veç ashtu qysh qëndron.
431. Respektoje më shumë të huajin se tëndin, por duaje tëndin më shumë se të huajin, se " i huaji s'bëhet kurrë i yti".
432. S'vritet njeriu, oreee...për hiq gjë!

433. Hajni e mban kokën ulur.
434. Mos u bëj punëtor i gjithkujt se të nënçmon.
435. Mos u bëj fshesë e shtëpisë së huaj.
436. Mos e ngacmo plagën, se bëhet më e thellë.
437. Kush mësohet i vogël, lëvdohet i madh.
438. Fitimi i keq vajti për dreq.
439. Sa më shumë gënjeshtër, besimi zvogëlohet, madje edhe humb.
440. Beso tek vetja jote, tek vlerat e tua, tek ajo që ke dhe mund ta bësh.
441. Në rrugën që ke nisur, mund të ketë dhe gropa ku ti mund të rrëzohesh. Por kjo nuk do të thotë që ti nuk mund të ngrihesh më të vazhdosësh rrugën që le në gjysmë.
442. Përqendrohu në qëllimin që ke.
443. Lufto për atë që dëshiron.
444. Dëshpërimi i madh e bren njeriun, sikur krimbi lisin.
445. Të mirës asnjëherë nuk i humb vlera.
446. Nëse gjërat i bën urtësisht, padyshim do dalin mirë.
447. Inati e pëlcet njeriun, e fishk si krimbi lisin.
448. E lehta shumë lehtë bëhet e vështirë.

449. Shumë më me vlerë është kur një i keq bëhet i mirë, se një i mirë të bëhet i keq.
450. Gjënë që ke, e lëvdon. Kur e heq, e nënçmon.
451. Të kuptueshmit i flitet shkurt, të pakuptueshmit gjerë e gjatë.
452. Shoqëria e keqe nuk ka zakone të mira.
453. Fjalës së thënë t'i qëndrosh çdo herë pranë.
454. S'dallohen derrat në fytyrë.
455. E sotmja qesh të djeshmen, e ardhmja qesh të sotmen.
456. Emri i mirë fitohet kur bëjmë punë të mira, kur i largojmë të këqijat nga vetja.
457. Kur të ngjitesh në maje të kodrës, do të thuash: "Maja nuk paska qenë aq e lartë!" Kur zbret poshtë, do të thuash: "Maja paska qenë mjaft e lartë!"
458. Një gjë, që nuk e di, trego të vërtetën që nuk e di. Të shtiresh kinse e di, është e turpshme. "Më mirë vërtetësia se turpëria".
459. Duke i mësuar të mirat, i largon të ligat nga vetja.
460. Dita vjen, dita kalon.
461. Më i keqi është ai që e përkrah të keqin.

462. Suksesin e arrijnë ata që përpiqen.  
463. Duro sa mund të durosh.  
464. E drejta e bën njeriun guximtar.  
465. Njeriut të mir gjithmonë bëji mirë.  
466. Shtëpia e vjetër mund dhe të riparohet...”Njeriu i devijuar “ mund të përmirësohet..  
467. Mos e qaj hallin, por zgjidhe hallin.  
468. Vëre sendin aty ku e ka vendin.  
469. Pa i futur duart në baltë, s’mund të fitosh “mjaltë”.  
470. Nëse bukën e ke fituar me djersë, me punë të ndershme, mos druaj, mund ta hash kudo.  
471. E kaluara plotësohet nga e sotmja.  
472. Dashuria e madhe s’gjen dot fjalë.  
473. Dashuria fle në shpirt.  
474. Mos u qaj nga e mira.  
475. S’të mban dega, por rrënja.  
476. S’e dinte qeni që ka veshë, atë e mësoi kur ia prenë.  
477. Kush punon, nuk mbet, shkon larg e drejt.  
478. Çdo gjë është diçka, padituria s’është asgjë.  
479. Të urtin nuk ke nevojë ta këshillosh, të marrin këshilloje sa të duash, e ke kot.  
480. Mos zgjidh, kur nuk ke zgjidhje.

481. Miqësitë e vërteta nuk ndodhin në çdo kohë.
482. Një i mençur i ushqen njëzet veta me mençuri.
483. I pashkolluari është i verbër.
484. Vullneti është çelësi i suksesit.
485. Njeriun e shëron puna.
486. Mundi i madh e dërgon njeriun në arritje të lartë.
487. Kur dikë e ke dashur me zemër, zemra nuk lejon që të largohesh lehtë prej tij.
488. Të fitosh emër për mirë, duhet të punosh shumë vite, kurse të fitosh emër për keq, mundesh çdo herë, dhe në çdo kohë.
489. Ne jetojmë për ata që na duan dhe respektojnë.
490. Mos druani asnjëherë, të investoni në dituri.
491. Mos iu frikëso atij që të sulmon, por atij që pas shpine të tradhton. Tradhtia vret pas shpine.
492. Nuk ka gjë më të rëndë, se mosmirënjohja e fëmijës ndaj prindërit..
493. Më mirë pak, se më pak se pak.

494. Përçarja e madhe, ndarja në prag të shtëpisë.
495. Ai që është në hall, ia qan hallin dhe një furrтари.
496. Mos u bëj armik i asaj që s'e njeh.
497. Poshtërimi më i madh bëhet në publik.
498. Përtimi-mjerimi.
499. Një punë të mirë, që keni bërë në të kaluarën, e ndieni vetën krenar në të tashmen.
500. Besoni, dhe ta doni qëllimin që keni.
501. Në një familje të harmonishme s'mungon lumturia.
502. Një prind i mirë nuk është ai që është tiran i fëmijëve.
503. Mos kërko që të bësh shumë miq, kërko që të bëhesh mik.
504. Prishja nga ish miku është shumë më e rëndë se armiku.
505. Boshllëkun më të madh në familje e lë ai që vdes.
506. Në çastet më të vështira lindën burrat më të mëdhenj.
507. Prej njeriut varet fati i çdo gjëje, madje edhe fati i vetë njeriut.
508. Suksesi arrihet me këmbëngulje.

509. Vetëbesimi është virtyt i mirëbesimit.
510. Në ditët e sotme njerëzit më shumë e duan të bukurën, si diçka fizike, se sa të bukurën shpirtërore.
511. Shqetësimi nuk i largon plagët, përkundrazi i thellon dhe më tepër.
512. Njeriu pa nder nuk ka vlerë.
513. Suksesi më i madh arrihet në rini e kujtohet në pleqëri.
514. Në çdo herë marrim këshilla nga të tjerët, por ndonjëherë duhen dhe ne ta këshillojmë vetën tonë.
515. Dikush flet mjaft e nuk tregon asgjë, dikush flet pak, mirëpo tregon shumëçka.
516. Dija nuk blihet me para, por fitohet me shumë mund e përkushtim.
517. Kokëfortësia-Budallallëku.
518. Gjërat e mira po nënçmohen, të këqijat po çmohen.
519. Pamja fizike nuk të bën shëmti, shëmti të bëjnë veprimet e këqija dhe mendja e keqe.
520. Hajnia në fillim nis në gjëra të vogla, pastaj del tek ato më të mëdha.



521. Mos e bëj një njeri veç si shok, por edhe si vëlla. Shoqëria mund edhe të zhduket, kurse vëllazëria gjithnjë mbetet.

522. Koha ik e nuk kthehet më. Mos e le kohën kot të ikë.

523. I sigurtë është ai njeri që i pranon të metat e tij dhe vlerëson suksesin e tjetrit.

524. Ne duhet ta kërkojmë të mirën e jo ajo ne.

525. Miku i mirë është bereqeti i shtëpisë, miku i keq është faqja e zezë e shtëpisë.

526. Thuhet ai që të do, të vlerëson shumë. Andaj duaje atë që të do.

527. Toka e mirë nuk i do njerëzit e këqij.

528. Nuk ka gjë më të rëndë për dikë që e respekton dhe e do një njeri, kurse ai nuk e do atë.

529. Kur njeriu i lë veprat e këqija, vërtet është i fituar, veprat e këqija nuk të dërgojnë askund, ato thjesht të dërgojnë në humbje, mosarritje. Trishtim. Veprat e mira e lartësojnë njeriun, e bëjnë krenar në çdo hap të jetës së tij.

530. Nuk është i keq veç ai që bën të këqija, po edhe ai që të nxit të merresh me gjëra të këqija.

531. Humbja e një anëtari të familjes mund të ndodhë në çdo kohë, madje edhe atëherë kur më së paku e presim.

532. Në jetë njeriu duhet të shoqërohet me ata njerëz që e bëjnë të ndihet mirë, me ata njerëz që brenda zemrës së tyre kanë ç't'i dhurojnë. Të shoqërohet me ata njerëz deri në përjetësi.

533. Të sundosh në familje është e vështirë, të mbash harmoni në familje është e lehtë.

534. Krenaria më e madhe për një prind është që fëmija i tij të rritet me lëvdë.

535. Gjykatësi më i mirë i një familje është fëmija.

536. Femra të mira nuk ka edhe aq, por ato që janë, janë pasuri e madhe e familjes dhe e shoqërisë.

537. Mendja kuptohet lehtë, kurse zemra mjaft vështirë.

538. Të merituarit nuk marrin mirënjohje nga të pamerituarit.

539. Frikacakët po të kishin guxim, do ta kthenin botën për së mbrapshti.

540. Kur fatin e kemi në dorën tonë, mund të jemi zot i mirëfilltë i vetë-vetës.

541. Një gjë e vërtetë që fshihet, nuk fshihet.

542. Dita mund të jetë e mirë ose e keqe, varësisht nga përjetimet e juaja.
543. Barku i mbushur, truri i thatë nuk bën.
544. Barrën tënde askujt mos ia ngarko, për fajin tënd askënd mos e fajëso.
545. Mos e bëj atë që thuhet, por bëje atë që të pëlqen dhe që duhet.
546. Tri gjëra i ka shqiptaria e ato janë: bashkimi, miqësia dhe bujaria.
547. Me njerëz të mirë nuk ngopet njeriu së biseduari, ata çdo herë të dhurojnë diçka të mirë.
548. Një njeri që është vërtet me zemër të mirë, ai nuk do të devijojë asaj rruge. Gjithnjë do të jetë i mirë.
549. Nëse dështon njëherë  
Mos e humb besimin.  
Nëse dështon herën e dytë  
Prapë mos i humb shpresat.  
E ke dhe një mundësi, ajo është mundësia e tretë.
550. Nëse një njeri ua thotë një fjalë të rëndë, e ju nuk ia ktheni, ai do të kuptojë se ju nuk bini në nivelin e ulët të tij, nuk merreni me njerëz si

ai dhe nuk e shpenzoni kohën kot për ata njerëz.

551. I sinqerti e ka zemrën e pastër.

552. Zemrat e buta i kanë mendjet e lehta.

553. Ndonjëherë bëhet edhe më keq se keq.

554. Jeta është e përbërë nga çaste të lumtura dhe të hidhëruara, por ti mundohu që çastin e hidhur të kthesh në lumturi.

555. Kush bën mirë, i dyfishohet e mira, kush bën keq i dyfishohet e keqja.

556. Një femër e mirë është bashkëpunëtori yt më i mirë gjatë gjithë jetës tënde.

557. E ardhmja përplot sfida e mundime, e kaluara përplot dhimbje e nostalgji.

558. Kush çdo herë punon, nuk vuan as nuk gabon. Ai, i cili asnjëherë s'punon, shumë vuan, me vështirësi jeton.

559. Ai njeri që bën punë të mira, çdo herë hesht, sepse puna e tij flet vetë.

560. Koha e lirë nuk shfrytëzohet për gjëra të kota, por për gjëra me vlerë.

561. Nuk është me rëndësi sa njerëz ta kanë pëlqyer një gjë, por çfarë janë njerëzit që ta kanë pëlqyer atë gjë.

562. Vërtet janë me fat ata njerëz, që kanë një femër të ndershme në shtëpi. Një femër e ndershme është për familje sa tre meshkuj.
563. Ne duhet ta vrasim fajin e jo njeriun.
564. Njeriu nuk duhet të bëhet i keq me fajin e tij, por me fajin e tjetrit.
565. Çdoherë, kur falet shtrembëria, dënohet drejtësia.
566. Paraja blen çdo gjë. Por jo edhe çdo gjë. Nderi dhe respekti nuk blihet me para.
567. Goja ngrit zërin, goja ulë zërin, goja ngrit njeriun, goja fëlliq njeriun.
568. Miqësia dhe shoqëria që zgjat shumë, vërtet është miqësi e sigurtë dhe pa interesa.
569. Vizitat e rralla, dashuria më e madhe, vizitat e shpeshta mërzhisin mikun.
570. Ai që pyet shkon kudo, ai që s'pyet s'mund shkojë askund.
571. Një shkëndijë e vogël ndez një qytet.
572. Njeriu i pa faj, fajësohet - se është me fajtorin.
573. Syri flet, edhe kur buza nuk flet.
574. Mos u shtir me një njeri kinse e do, sepse dashuria e pa vërtetë (e rreme) është më e keqe se urrejtja.

575. Respekti dhe dashuria sundojnë këtë botë.
576. Momentet e bukura kujtohen çdo herë, ato janë bërë me njerëz që janë të bukur në brendësinë e shpirtit të tyre.
577. Zhgënjimi më i madh ndodh atëherë kur besimi është i tepruar.
578. Ne zemërohemi dhe inatosemi me njerëz që i duam, sepse ia duam të mirën njëri-tjetrit.
579. Shumë më me vlerë një buzëqeshje e sinqertë, se sa një puthje false.
580. Të gjithë kemi lindur që të jemi të rëndësishëm diku. Mjerë ai njeri që nuk është i rëndësishëm askund.
581. Një shikim i keq është më i rëndë se shumë fjalë të këqija, një shikim i buzëqeshur thotë sa shumë fjalë të mira.
582. Disa njerëz nuk ta gëzojnë veç fytyrën, por dhe zemrën. Disa të tjerë ta trishtojnë fytyrën, djegin zemrën.
583. Ndonjëherë njeriu, dashuron aq shumë një tjetër njeri, sa që mund të harrojë dhe vetën e tij.
584. Gabimet e bëra nuk kthehen pas, mund të mos ripërsëriten.

585. Dashuria, Besimi, Respekti e Miqësia e mbajnë këtë botë.

586. Asnjëherë mos e bëj atë që përton ta bësh, mos e bëj atë gjë që vërtet s'të pëlqen ty, dhe nuk e ndien vetën rehat asnjë moment. Edhe nëse dikush të ka imponuar ta bësh , ti mos u shqetëso, sepse të tjerët mundohen edhe të të devijojnë ty, po “ti njihe mirë vetën tënde”.

587. Asnjëherë mos u bëj i tepërt për një njeri. Mosinteresimi tregon që ju jeni i tepërt në jetën e tij.

588. Vullneti i madh rrugën e gjatë ta bën të shkurtë, vështirësinë ta bën lehtësi, qëllimin që ke arritshmëri..

589. Grindje e tepërt, shkak i miqësisë së tepruar.

590. Vërtet i përqeshi ata njerëz që thonë:”Leximi i tepruar të bën budallë!”. Joo oreee, leximi ua heq budallallëkun që keni.

591. Ena e keqe s'thyhet dot.

592. Një femër, të kompletuar, e bën pamja e jashtme dhe brendësia e bukur shpirtërore.

593. Jetojmë në një shoqëri, kur njerëzit i kanë nervat e ngushta.

594. Të zemëruarit i humb udha në oborr.

595. Një herë në jetë na jepet mundësia të jemi dikushi.
596. Ka njerëz në këtë jetë që i kujtojmë në çdo çast. Edhe po të dëshirojmë ne të ikim prej tyre, shpirti dhe zemra i do çmëndurisht.
597. Një femër e ndershme ka vlerë mjaft të madhe, saqë s'thuhet dot me fjalë. Një femër e pandershme s'ka kurrfarë vlere.
598. Një vajzë e kuptueshme i kupton gjërat më mirë dhe më hollësisht se shumë meshkuj.
599. Fjala e bukur e pastron shpirtin. Fjala e hidhët helmon, djeg pjek shpirtin.
600. Mos u bëj më idiotec se idioteci.
601. Ajo që më pëlqen tek një vajzë, janë ndershmëria, sinqeriteti dhe buzëqeshja.
602. Nuk i dua ata njerëz, që asnjëherë në jetën e tyre s'ia qerasin dikujt as dhe një kafe. Po e jetojmë në një jetë, kur sot jemi nesër nuk jemi. Andaj bëji dikujt nder sot, se nesër është ndoshta vonë.
603. Njeriu me dashuri dhe respekt shkon kudo. Me agresivitet nuk shkon askund. Edhe nëse shkon, bie shpejt.



604. Ne duhet të jemi krenarë që kemi një person të moshuar në shtëpi. I moshuari gjithnjë i ka këshillat e mira.

605. Njerëzit e mirë na gjinden në ditët më të vështira, por ne duhet t'i kujtojmë në ditët më të lehta edhe atëherë kur nuk kemi nevojë për ta.

606. Inati ndonjëherë të ndihmon. E bën njeriun të përpiqet, të kërkojë më shumë nga vetja e tij.

607. Qeshja tërheq njeriun, zbukuron njeriun kënaq zemrat.

608. Frika është shkaktare:e stresit, ankthit çrregullimeve psikike.

609. Dhurata më e çmuar që ke nga Zoti, është gruaja e mirë.

610. Vendimet merren në fund, e jo që në start.

611. Bukuria vërtet është ajo që e dallon njeriun nga jashtë, por veçantia e tij shihet përbrenda. Nëse brendësia e tij është e pastër, ai njeri ka shumë vlerë.

612. E drejta zhytet, por nuk humbet.

613. Nuk bëhen gjërat çdo herë symbyllas.

614. Ne nuk kemi kohë të merremi me njerëz të këqij, sepse nuk po ngopemi asnjëherë me njerëz të mirë.

615. Mos i hidh gurët përpjetë, se të bien në kokë.

616. Trimi rron me trimëri, frikacakun e mbyt frika.

617. Në këtë jetë dikush gëzohet më shumë se gëzimi, kurse disa të tjerë hidhërohen më shumë se hidhërimi.

618. Kur i kërkon dikujt hua, në fillim ndihesh rehat. Më vonë kur të vijë koha ta kthesh borxhin, fërkon kokën tënde.

619. Asnjëherë mos e lëvdo vetën tënde, sepse sa më shumë e lëvdon vetën tënde, aq më pak je i lëvduar. Nëse je vërtet i mirë, lëvdatat nuk të mungojnë. Nuk jemi ne ata që e vlerësojmë vetën tonë, të tjerët na vlerësojnë për punën që ne bëjmë, qoftë e mirë apo e keqe ajo.

620. Vullneti i mirë të vështirën ta bën jo të vështirë.

621. Mos i bëj ato gjëra që e prishin identitetin tënd.

622. Vepro ashtu qysh të thotë mendja, por jo që dikujt t'i djeg zemra.

623. Kërkoje gjithnjë atë që do, jo atë që e gjen.

624. Realiteti i diçkaje shpesh të duket si ëndërr, e ëndrra të duket si të ishte një realitet.

625. Kur ishim të vegjël, thoshim me vete: “Kur do që të vijë koha që të rritemi”. Kur u rritëm, kuptuam se koha ik e s’kthehet më, kuptuam se mosha rinore është mosha më e bukur e jetës. Andaj, punoni dhe mundohuni më së shumti në rini, sepse suksesi më i madh arrihet në rini e kujtohet në pleqëri.

626. Një njeri të dashur sado larg që e ke, dashuria për të është e pranishme brendësisht në shpirtin tonë. Dhe na bën që atë person të dashur ta kemi afër vetës kudo, edhe pse ai mund të gjendet shumë larg nesh.

627. Ne, në një farë mënyre, jemi të detyruar t’i duam ata njerëz që shpirti dhe zemra i do marrëzisht. Jeta pa ata na duket shumë boshe dhe e vrazhdë, ani pse ata persona mund të mos na duan neve.

628. Kur u rritëm dhe arritëm një moshë të pjekurisë, kuptuam se nuk ia kemi ditur rëndësinë sa duhet kohës rinore. Çdo herë ditët e rinisë mbeten ditët e arta për çdo njeri , mbeten çastet më të bukura që i kemi përjetuar, mbetet shoqëria e paharruar. Vërtet ditët e rinisë na zgjojnë kërshëri të madhe t’i kujtojmë, por njëkohësisht na zgjojnë nostalgji,

plagë shpirti që mbetet përherë e paharruar në kujtesë.

629. Gjëja më e vështirë në ditët e sotme është që të jesh i mirë. E mira po nënçmohet skajshmërisht, e keqja po vlerësohet.

630. Të gjitha atributet sot po i takojnë të pamerituarit. I merituari ku po mbetet.

631. Nëse vërtet ke një mik, që kuptohesh lehtë me të ke shumëçka. Ata të cilët zënë çdo kë “mik”, duket se nuk e kanë asnjë mik. Një mik mbahet lehtë, shumë miq- me vështirësi.

632. Ca njerëz sot bëjnë gjithkënd “mik” ...veç që të bien në sy të të tjerëve.

633. Bëj qejf sot, se nesër mund të mos vijë mundësia.

634. E djeshmja dhe e nesërmja nuk janë njësoj.

635. Drurët e hollë barten lehtë, por krasiten me vështirësi. Drurët e trashë krasiten lehtë, por barten me mjaft vështirësi.

636. Atë gjë që ke mundësinë të ndreqësh, mos e prish.

637. Ka ca njerëz që kur i bëjnë kushtet e mira jetësore, kanë pasuri dhe luks të tepruar, harrojnë ata njerëz që deri dje kanë ndenjur me ta, harrojnë ata njerëz që janë rritur bashkë,

kanë kaluar çaste të lumtura dhe të hidhura së bashku. Komoditeti dhe luksi i tepruar mund të mos zgjasë përherë, shoqëria e vërtetë dhe pa interesa gjithnjë mbetet.

638. Disa njerëz nuk janë të kënaqur veç me luks, kërkojnë mega-luks.

639. I pasuri lufton për gjëra luksoze, i varfëri punon për kafshatën e gojës nga mëngjesi deri të erret nata.

640. Karakteri të dallon si njeri, bukuria po nuk e pate karakterin, nuk të zbukuron si njeri, as nuk të shëmton si njeri.

641. Mua nuk më dhimbset asgjë për njeriun e mirë, një njeri që më bën një të mirë, kam dëshirë t'ia bëj njëzet të mira. Fundja, ne jetojmë për ata që na duan dhe na respektojnë.

642. Ndonjëherë njeriu duhet që gjërat e lehta t'i bëjë të vështira, kurse gjërat e vështira t'i bëjë të lehta.

643. Ndonjëherë gjërat e lehta dalin më të vështira se ç' i kemi paramenduar, kurse gjërat e vështira dalin më të lehta se ç'i kemi parashikuar.

644. Ka gjëra që në mendjen tonë jetojnë më gjatë dhe na shfaqen shpesh para ekranit të

vetëdijes. Kur nxjerrin kokë ato gjëra, nuk i lënë gjë tjetër njeriut, veçse të merret me to.

645. Jeta nis e bukur, ndesh në barriera, jeta vazhdon nëpër brenga dhe arrin majat.

646. Mendo që me fjalë të mos vrasësh askënd, rimendo që me fjalë të bësh miq dhe armikut t'ia heqësh armiqtë.

647. Vuajtja për dembelin sjell djerrësi, për jetimin sjell pikëllim.

648. Çdo herë zemra jonë dëshiron t'i ketë pranë vetës ata persona që për ne janë shumë të rëndësishëm, që ne na bëjnë të ndihemi të lumtur, kur i kujtojmë, ose kur qëndrojmë pranë tyre. Shpirti dhe zemra nuk mundet pa këta persona. Kujtimi për ta është përherë i freskët dhe dashuria ndaj tyre është thellësisht e zjarrtë.

649. Njeriu ndien dhimbje dhe pikëllim, kur kujton gjërat që ka mundur t'i bëjë në të kaluarën.

650. Njeriu me kohë kupton shumëçka, ah sikur t'i kuptonte gjërat që nga fillimi.

651. Njeriu në këtë jetë kish lloj-lloj gjëra që mund t'i zë, por ishin ca të tjera që edhe nëse mundohesh, kot e ke, s'mund t'i zësh dot.

652. Mos i bjer veglës, nëse nuk di të këndosh, mos këndo nëse nuk di t'i biesh veglës.

653. Në atdheun tonë jemi të etur, kurse në tokë të huaj si në një botë me ujë.

654. Dikush sheh natën, unë jo as ditën.

655. Të gjitha gjërat e mira e bëjnë njeriun të veçantë, e bëjnë të dallohet nga të tjerë. Më thjesht, e bëjnë të jetojë gjatë në zemrat e atyre që e duan.

656. Ne vërtet vajtojmë për gjërat që s'i kemi, e kemi dëshirë t'i kishim. Po njëherësh duhet të vajtojmë për këto që i kemi pranë që të mos na humbasin.

657. E bukura nuk ka nevojë asnjëherë për teletisje.

658. Në ditët e sotme ia thotë njeriu-njeriut fjalën e rëndë pa fije turpi, në kohët e mëparshme edhe nëse ia thoshte, së paku ishte mpakur në fytyrë.

659. I pasuri mund të bëjë dasma për ditë, por jo martesë.

660. Jo gjithherë e ngrohim vetëm ne shpirtin me buzëqeshje, edhe të tjerët mund të na ngrohin në shpirt me buzëqeshje të vërtetë e jo buzëqeshje llahtarie.

661. Njeriu i lënduar thellë, është si njeriu i humbur.

662. Gjallesat e tjera në tokë më së paku flasin për dashurinë, e vetë tërbohen pas seksit.

663. Puna që ka vlerë dhe që është e mirë, s'duhet sharë as s'duhet ndyrë.

664. Arritjet më të mëdha arrihen kur je i etur për sukses.

665. Nëse një njeri u ka dashur një kohë, e tani nuk u do më, hynorja e juaj shpirtërore ende mund të ta dojë, sepse në të kaluarën ka qenë personi më i rëndësishëm në jetën tuaj, andaj nuk mund të ikim lehtë prej tij.

666. Mëso nga çdo ditë, ke kohë që të bëhesh i mësuar.

667. Ne shokë mund të zëmë çdo ditë, por shokët e vërtetë zihen mjaft rrallë.

668. Po të dinë disa njerëz se sa i kujtojmë dhe i duam, do të habiteshin apo çmendeshin mendërisht.

669. Nuk ka gjë më të rëndë se të duam me shpirt një person e ai të mos na dojë, të mendojmë për të e ai të mos mendojë asnjëherë për ty, të jetosh për të e ai as mos të flasë me ty.



670. Njeriu mund të shoqërohet me çdo kë, por nuk po na jepet mundësia çdo herë të shoqërohemi me ata që duam.

671. Ne jemi vërtet të mirë e të ndershëm, atëherë kur shoqërohemi me ata njerëz që janë më të mirë se ne.

672. Dallimi në mes njeriut të ndershëm dhe të marrit, është se i ndershmi bën çdo herë punë të ndershme (të mira), kurse i marri vetëm marrëzira.

673. I dituri flet me dituri, i padituri flet çka ka dëgjuar.

674. Mos e përgojo tjetrin, përgojimet asnjëherë nuk sjellin dobi.

675. Ke kujdes çdo hap ku e hedh..

676. Gjërat kthehen edhe atëherë kur nuk të duhen më.

677. Fitove besimin e dashurinë, ke fituar çdo gjë.

678. Nëse nuk shkon pas asaj që dëshiron, s'do ta kesh asnjëherë.

679. Lumturia shumë shpejt mund të kalojë në hidhërim e hidhërimi në lumturi.

680. Për ata që i duam nga thellësia e shpirtit, bëjmë më shumë se gjithçka.

681. Njerëzit e këqij të lëprijnë me gjuhën e së keqes.

682. Morali nuk matet me vite.

683. Njohuria e vret besëtytninë.

684. Bukuria më e madhe e një njeriu është mirësjellja, ajo e bën njeriun çdo herë të duket bukur.

685. Arritjet më të mëdha arrihen, kur je i etur për sukses.

686. Ne shokë mund të zëmë çdo ditë dhe në çdo kohë, por shokët e vërtetë zihen mjaft rrallë.

686. Një femër vërtet e quaj me nder, atëherë kur e respekton dhe nderon njerëzit në atë familje ku është martuar, më shumë se bashkëshortin e saj. Por njëherazi nderon dhe mirëpret ata që vijnë në atë familje. Një femër që i ka këto cilësi, është tamam femër e ndershme me vlerë të lartë.

687. Në ditët e sotme shumë njerëz po sillen keq, secili mundohet të sillet më keq se tjetri, me të vetmin shkak që të bien në vëmendjen e të tjerëve. Në njëfarë mënyre po mundohen që të pëlqehen nga të tjerët dhe të bëhen të frikshëm.

Shumë nga ne i pëlqejmë këta persona dhe i quajmë të "fortë"... por në realitet këta persona në vend që të ngrisin vetën me gjëra që i sjellin sukses, ata me gjestet e tyre të këqija e të pamatura po e fundosin vetën, po e tregojnë karakterin e dobët duke rënë në nivelin më të ulët të mundshëm

688. Gjërat e bëra s'kthehen pas, por gabimet mund të përmirësohen.

689. Gjërat e ndyra dhe të pista bëhen nga njerëz të cilët nuk i bren ndërgjegjja.

690. Njeriu është qenia më e përsosur dhe më enigmatike, asnjëherë nuk dihet çka fshihet brenda tij.

691. Punët kryhen në bazë të disponimit.

692. Kur ke disponim të mirë, edhe një punë që nuk e di, të duket vetja që e njeh.

693. Shumë herë një punë që na duket shumë e vështirë, kur hyjmë në të, na duket më se e lehtë.

694. Njerëzve, që, për ne janë shumë të veçantë, ua duam dhe shpirtin.

695. Mos e parapëlqej lazdrimin e tepërt, se nuk të shpie askund.

696. Njeriun e vlerëson kuvendi.

697. Pas një fytyre, fshihen shumë fytyra.
698. Flet një herë, dëgjon gjithkush, flet dhjetë herë s'dëgjon askush.
699. Jeto për atë që ta hap derën çdo herë, kur fillon të trokasësh.
700. Më mirë gjërat të kuptohen që në start, se dikur bëhet vonë.
701. Çdo herë po mundohem të jem edhe më i mirë, që të mos ia prish askujt qejfin dhe disponimin, por në ditët e sotme është vështirë të jesh i mirë.
702. Përderisa nuk e bëj vetën që të më bërtasë ndokush, nuk kam dëshirë që asnjëri të ma ngrisë zërin para meje.
703. Kur ndokush bëhet i keq me mua, unë do të jem dhjetë-fish më i keq me të.
704. Për të keqin, jam më i keq se i keqi.
705. Vërtet jam shumë i mirë me ata njerëz që më duan dhe më respektojnë sado pak. Një njeri që sado pak më bën mirë, dëshira ime është që t'i trefishoj të mirat. Një njeri që sillet keq njëherë, unë sillem dyfish më keq se ai, dhe ai person është i parëndësishëm për mua, nuk ka respekt më nga ana ime dhe për mua është i pa vlerë.

706. Mosmirënjohja e një personi që e do, shkakton inat.

707. Respekto mendimin e tjetrit, por bëj si thotë zemra e juaj, e cila është përfillëse e mendimit.

708. Ka ca njerëz që ndërhyjnë në trupin e tyre me operacione plastike, duke u munduar të bëhen tërheqës për të tjerët. Këto gjëra mund edhe ta zbukurojnë njeriun, por jo gjithherë. Dituria, urtia e mirësjellja e bëjnë njeriun të ndihet i veçantë dhe i zbukuruar tërë jetën.

709. Çdo të keqe që bëni, jeni duke hapur varr në zemrën e nënës dhe babait.

710. Mjafton njëherë që të luhatet besimi.

711. Nuk na duhen lariçkat dhe mendjemëdhenjtë.

712. Duhet të dallohet atdhetari nga tradhtari.

713. Ai që mendon vetëm për interesa personale, është njeri i ulët.

714. Puno çdo ditë e më tepër, që të kesh ardhmëri të ndritur.

715. Ne qajmë dhe ndjejmë nostalgji për të kaluarën.

716. Dua je dyfish më shumë atë që të do.

717. Duaje dhe vlerësoje atë që ke, pa u krenuar me atë që ke, s'mund të arrish më shumë.
718. Mos shpresë në gjëra të kota.
719. Një njeri i mësuar ka dëshirë të mësojë edhe nga të tjerët, kurse injoranti nuk lejon të mësojë nga të tjerët.
720. I padituri të diturin mundohet ta mësojë.
721. Dembelia është sëmundje e njeriut, që vështirë shërohet.
722. I buti e mund të fortin jo me fuqi, por me fjalë.
723. Të mirët po kuptohen keq nga jo të mirët.
724. Më dhemb kur flasin për nder e moral ata që po e bëjnë haramin më shumë se harami.
725. Arrat e forta s'thyen me dhëmbë.
726. Nëse e çmon të keqën, bën më keq se i keqi.
727. Ka ca gjëra që e brejnë njeriun si krimbi lirin e ato janë: zemërimi i tepërt dhe inati.
728. Nganjëherë e lë një njeri që të më bëjë keq, veç që të mos bjerë dhe unë në nivelin e ulët të tij.
729. Personat e dashur na flenë në shpirt, i kemi pas vetës kudo që shkojmë, çka do që bëjmë, çdo hap që shkelim. Jetës sonë i japin rëndësi

këta persona, nuk mendohet jeta në asnjë mënyrë pa ata.

730. Njeriu shumë lehtë bie poshtë, por vështirë është të kthehet lartë (ku ka qenë).

731. Disa gjëra i kam urryer, dhe vazhdoj t'i urrej më shumë se urrejtja.

732. Nuk dua që ndokujt t'ia presë as mizën nga trupi, por nuk dua që as mua të ma pret ndokush mizën.

733. Në vendlindje pushojnë trupi dhe shpirti.

734. Shumë herë te nxënësit dija e tyre nuk konsiston me suksesin që kanë, disa mësojnë për dije, disa veç për një notë. Disa marrin nota më tepër se që kanë merituar, disa të tjerë më të ulëta se që kanë merituar.

735. Njeriu punëtor nuk ka nevojë për lëvdata e vlerësime, e vlerëson puna që ai kryen.

736. Duaj me shpirt, duaj me zemër duaj sinqerisht.

737. Më mirë merru me diçka të kotë, se të sillesh kot.

738. Nuk tregohet trimëria ndër vëllezër, trimëria tregohet ndaj armikut dhe mbrojtjes së truallit stërgjyshor.

739. Për gabimet e bëra pendohem më shumë se pendimi, çdo njeri në këtë jetë është gabimtar. Dashtë Zoti e i falet gabimi.

740. Të mirin e dua pa fund, me të keqin nuk kam punë.

741. Nëna është shtylla e familjes, pa të familja ndihet shumë e zbrazët.

742. Atë që bëjnë prindërit për ne, ne nuk mund t'ia kthejmë as gjysmën edhe po deshëm. Por kur të rritemi e kemi me borxh t'i përkrahim, t'i nderojmë, t'i duam më shumë se çdo kë tjetër, sepse ata sakrifikuan jetën e tyre për ne, na u gjendën në rastet më të vështira e na deshën më shumë se vetën. Sado që mundohemi t'ia kthejmë të mirat, borxhi ndaj tyre nuk mund të kthehet gjithë jetën. Ata buzëqeshën kur na shihnin neve duke buzëqeshur, u prekën thellë në zemër kur na shihnin neve të zemëruar, çdo hap të jetës së tyre për neve jetonin.

743. Njeriu ndihet rehat kur është shpirtërisht mirë.

744. Humbja e nënës, anëtarit më të dashur të familjes, krijon boshllëk të madh në atë familje.

745. Loti e çmall njeriun, e liron nga energjia e grumbulluar.



746. Heronjtë mbrojtën çdo pëllëmbë të vendit të tyre, që ne të frymojmë të lirë.

747. Njeriu ndien mall, kur largohet prej dikujt që e do.

748. Ndonjëherë ditët duken si vite e javët si shekull.

749. Burrin nuk e bën trim arma, por fjala e mbajtur.

750. Dashuria është ndjenjë e thellë shpirtërore. Mbi të gjitha, është art i së bukurës shpirtërore.

751. Më me vlerë është të jesh i mirë në mesin e të mirëve, se të jesh i mirë në mesin e të këqijve.

752. Kush e zë ujkun, nuk ka frikë nga qeni.

753. Nuk të dallon mosha e bukuria fizike, por mendja e ndritur.

754. Njollat e pafytyrësisë nuk ka gjë që i pastron.

755. Mos e mbaj mend të mirën që ia ke bërë dikujt, mbaje nëmend të mirën që të ka bërë dikush.

756. Hëna është e bukur kur është e plotë, ashtu e ka edhe miqësia.

757. Kur të nxit vetja për diçka, nuk mundet askush të të ndalojë.

758. Nëse ia ke frikën lepurit, po luanit?
759. Nuk ka më gjynah që të marrësh djersën e huaj.
760. Nëse një njeri nuk është i mirë për vëllezërit e tij, nuk mund të jetë i mirë për askënd.
761. Mos u bëj pasues i shëmtisë.
762. Familja është jorgani yt, pa të ti ndihesh ftohtë.
763. Disa kujtime zbehen, ca të tjera fuqizohen.
764. Mos e akuzo punën, po zgjidhe punën.
765. Bëhu i arsyeshëm, bëhu me vlerë.
766. S'bëhen gjërat kur je mëdyshas.
767. Trupi i fortë lodh mendjen, trupi i lodhur çlodh mendjen.
768. Dija vret hasmin mu në ballë.
769. Budallai e thyen akullin me kokë.
770. Iu duk ëndërr qenit, kur i kërceu ujku për ta ngrënë.
771. Mos e shqelmo të mirën, që ta ledhatosh të keqën.
772. Të djeg hiri, po zjarri?
773. Dashuria ndjen mall, malli ndjen dashuri.
774. Fol si të ka hije, jo çka ke dëgjuar.

775. Nëse deshe të mbrosh shëndetin, atëherë ndalo duhanin.
776. Duhani çdo ditë e më tepër po vret njerëz, mos u bëj edhe ti ndër ata.
778. E nga të shkoj unë i ngrati!
779. Çdo herë largohu nga më e liga.
780. E liga bëhet sa çel e mbyll sytë.
781. Pas trëndafilut të bukur fshihet edhe ferra.
782. Mendje e ndritur, zemër kalbur.
783. Dallohu nga dikushi, mos u bëj si gjithkushi.
784. Buzëqeshja shton jetëgjatësinë e njeriut.
785. Mos ia bëj vetës punët katastrofë, po as rrafsh çdo herë.
786. Mirëqenia e madhe nganjëherë mund të çmend njeriun.
787. Aktivitet e lira ngrisin, zbukurojnë dhe e lartësojnë njeriun.
788. Të merremi me diçka e jo me asgjë. Pasiviteti është vdekje.
789. Sikurse mbeturinat që nuk të duhen e i hedh në shportë, ashtu edhe të këqijat ( të ligat) largoji nga vetja.
790. Durueshmëria dhe toleranca mbizotërojnë tek njeriu me vlerë.

791. Tiparet që më pëlqejnë tek një vajzë, janë :sinqeriteti, ndershmëria, vetëmohimi dhe buzëqeshja. Një vajzë që i ka këto tipare kam simpati për të.

792. T'i lëmë hilet dhe inatet që kemi mes vete.

793. Dëshira dhe vullneti për të arritur sukses, te unë është e etur në shpirt.

794. Ke kujdes: disponimi shumë shpejt kalon në indisponim.....

795. Mos të mbulofshin retë e zeza!

796. Mirësjellja është ajo që nuk e zbeh asnjëherë njeriun.

797. Aleati më i fortë i njeriut është durimi.

798. Mundohu që ta respektosh maksimalisht atë që të do, mos u merr me atë që pas shpine të tradhton.

799. Shokë të zemrës, në ditët e sotme, ka shumë pak.

800. Zoti na i ruajt ata njerëz që jeta jonë nuk ka vlerë pa ta, jeta jonë pa ata duket e hidhët dhe boshe, gëzimi, lumturia buzëqeshja janë vetë ata. Jeta është e kotë pa ata.

801. Fjala më e ëmbël në botë është kur i thua dikujt me zemër :Të dua.

802. Dhurata më e mirë dhe më e çmuar që duhet bërë njerëzve të merituar, është dashuria e sinqertë.

803. Dashuria e rreme nuk ka asnjë lloj vlere.

804. Rinia janë perspektiva më e madhe e këtij vendi.

Rinia janë shtylla e shtetit

Një shtet që nuk ka rini

Shembet.

805. Gjithë ata njerëz të paarsimuar, janë bërë politikanë të afirmuar.

806. Urdhërdhënësi çdo herë shërbehet nga shërbëtori.

807. Koha po ik shpejt, mundohu që asnjë çast të mos e humbasësh. Çdo çast i humbur është dëm për ty, çdo çast i fituar të favorizon ty, andaj favorizo suksesin.

808. Kur kompetencat kalojnë te i marri, nuk ka më gjë aty.

809. Arti i dashurisë mësohet, nuk lind që në fill.

810. Dashuria pa interes, është e përjetshme.

811. Ndonjëherë më mirë thjeshtësia, se moda dhe luksi i tepërt mund të të bëjnë të "shëmtuar".

812. Mos mendo veç për të tjerët, shikoje njëherë vetën tënde ku je.
813. Ec nëpër kujtesë se nuk humbet.
814. Çka po dëshiruan zemra dhe shpirti, trupi asnjëherë s'mund ta ndalojë.
815. Puno për jetësimin dhe forcimin e shtetit tënd.
816. Të jesh në dijeni me çfarë personash je i rrethuar.
817. Pislleku nuk mund të jetë ndryshe, veçse gojë-pistë.
818. Mos iu ngjaso atyre që ta duan të keqën, se bëhesh edhe më i keq se ata.
819. Më së shumti paragjykojnë ata që dinë më së paku.
820. Ne si popull na duhet durimi.
821. Poeti di t'i gjejë fjalët si në kolovajzën e florinjtë.
822. Fjala dhe harresa – ky binom i përjetshëm.
823. Ka ca gjëra që vetja jonë nuk mund t'i përshkruajë me fjalë, mirëpo shpirti dhe zemra i dinë më së miri ato gjëra.
824. Gjërat e bukura e relaksojnë trupin dhe shpirtin deri në ngazëllim.

825. Kujtimet e fëmijërisë janë pjesa më e bukur e jetës, ato në mendjen tonë lënë mbresa dhe gjurma të pashlyera. Janë ato që e nxisin kujtesën tonë (ekranin e vetëdijes ) që të merret me to. Edhe kur na janë zbardhur flokët kemi nevojë për përkëdheljen e kujtimeve të fëmijërisë, ato e shoqërojnë njeriun në çdo hap dhe në çdo kohë, njeriu ndihet i mallëngjyer nga ato përjetime... janë po ato që e çmallin njeriun.

826. Të paragjykosësh është lehtë, të vlerësosh është vështirë të vlerësosh vetën edhe më vështirë.

827. Lumturia nuk të zvogëlohet, nëse e ndan me të tjerët.

828. Mos e gjyko një njeri, nëse nuk rri me të dhe nuk je pjesë e jetës së tij.

828. Bukuria shpirtërore, thjeshtësia, morali, ndershmëria dhe buzëqeshja, e bëjnë një vajzë të dallohet

829. Asnjëherë mos ia shteron vetës mundësitë dhe qëllimet që ke, edhe nëse nuk mund të realizosh më të mirën së paku bëj të mira sa më shumë që bën të mira, aq më tepër dyfishohet e mira.

830. Dashuri është ajo gjë kur: Mishi tretet nga trupi, lulet djersiten nga malli, sytë vezullojnë nga buzëqeshja dhe lotët pikojnë curril nga gëzimi.

831. Nëse dëshiron ta ndihmosh një të ri, jepja kurajën.

832. Neveritjet e tepërta janë shkas i humbjes së besimit dhe dëshpërimit të thellë.

833. Njeriu, për asnjë gjë, nuk mund të thotë se e ka bërë më të mirën dhe nuk ka më mirë. Por e rëndësishme është ta ndjekim të mirën dhe të kemi qëllimin e mirë.

834. Bukuria edhe nga larg, sado pak ngop shpirtin e pangopur.

835. Moshë rinore është mosha më e ëmbël e jetës. Ajo na shfaqet përherë në kujtesë, duke na krijuar nostalgji dhe lot malli. Kur ajo na shfaqet në kujtesën tonë, "u ngjason fëmijëve që kërkojnë të pinë në gjirin e nënës"...edhe kur na janë zbardhur flokët e na është rrudhosur fytyra, kemi nevojë për rifreskimin e kujtimeve fëmijërore kur ato shfaqen nuk i lënë gjë tjetër ekranit të mendimeve veçse të merret me to.

835. Sikur gështenja sa më tepër hapësirë përballë diellit aq më të shëndosha, aq më të



mëdha dhe më të ëmbla i bën frytet dhe njeriu sa më shumë dije e mençuri e ngrit së pari vetën si personalitet, pastaj nivelin kulturor e arsimor në vend

836. Më së shumti dhemb e qesh fëmijëria në kujtimet tona.

837. Sytë tanë vezullojnë nga një ndjenjë e thellë vëllazërore për ata që i duam.

838. Nganjëherë njeriut, nga dhimbjet e mëdha, i duket se po i rrokullisej një bjeshkë e tërë.

839. Thjesht, e shtrembra dhe e drejta nuk shkojnë së bashku.

840. Sikur një ditë, si dielli midis reshë, të shkëlqente e mira dhe e keqja të merrte fund...

841. Kur e padrejta mendojmë që ka fituar, është e drejta ajo që godet padrejtësinë.

842. Sikur krimbi që e bren lisiin, njësoj dhe njeriu thahet si lisi kur ia mbysin fjalën dhe mendimin e drejtë.

843. Zemra digjet, nga dëshira për të pasur një femër të ëndrrave tona.

844. Ndjesi e keqe të jesh i thyer shpirtërisht.

845. Njeriut i nevojitet një shikim dashamirës për t'i dhënë njëfarë përkrahje apo vetëbesimi.

846. Mëkat që të tjerët, nuk gjejnë dot mjete për të kuptuar shqetësimin tënd.
847. Mos e përtyp maltretimin.
848. Çdo njeri brenda shpirtit të tij fshehë dhimbje të padukshme.....
849. Njerëzit e rezistencës dhe vetëflijimit duhet të mbesin çdo herë të paharruar në kujtesën e popullit.
850. Thashethemet janë imtësi të pavlera që i bëjnë dëm njerëzimit.
851. Mos lejo që të nëpërkëmbin, balta mbi fytyrë s'durohet.
852. Xhelozia të fut në gabime të pafalshme dhe ta cenon suksesin.
853. Atë që nuk e ndiej, nuk e pëlqej asnjëherë.
854. Nuk duhet që e liga, të sundojë çdo drejtim dhe e drejta të mbetet asgjë tjetër veçse fjalë në letë.
855. Kur njeriu harron prejardhjen e vet dhe bëhet vëlla me armikun më të ndyrë duke e ndihmuar atë për të sendërtuar veprat më të pista e më të liga. Ai njeri nuk e ka më atë origjinë atë kombësi që e kishte të trashëguar nga gjyshi e stërgjyshi, jo kombësi, ai identitet, i mbeten veç në letër.

856. Nëse një femër të pëlqen marrëzisht, edhe nëse përpara saj të dalin pesëdhjetë femra të tjera, shpirti prapë e dashuron atë që e do marrëzisht. Ajo jetës sonë i jep kuptim, ëmbëlsi, vlerë, dritë e krenari, asnjë femër tjetër nuk ngjason me të, ajo thjesht të jep motiv jete e ngrohtësi shpirti.

857. Sado që kalojnë decenie jete, nuk e dobësojnë sensin e kujtesës sonë.

858. Mos u merr me broçkulla, ato nuk sjellin dobi.

859. Gjeturi është të jesh dinamik e kureshtar, që t'i përcjellësh gjërat rreth e larg teje.

860. Mërzia, çdo herë më e madhe se tmerri.

861. Energjia rrezatuese i paraprin njeriut, duke e paralajmëruar atë për të mirën e të ligën.

862. Mençuria është mësuesja dhe këshilltarja më e mirë në situatat më të vështira.

863. Njeriut i duhen tri gjëra: të ruhet, të kujdeset dhe të përmbahet

864. Dashuria nuk ka shumë gjuhë.

Ajo flet me sy.

Mjafton një shikim ëmbëlzues,

një shikim simpatik,

një buzëqeshje e ngrohtë dashamirësie,

një dorë që e shtrëngon dorën,  
një puthje që e shkrin dëborën,  
një gjoks që e ngrohë kraharorin,  
një fjalë që i ngroh zemrat.

865. Brenga gërryese, njeriun e mundon  
përbrenda.

866. Pa lexim, njeriu asnjëherë nuk mund të  
formohet si personalitet i mëvetësishëm.

867. Një femër e pëlqyer,  
t'i çon peshë të gjitha ndjenjat nga thellësia e  
shpirtit,  
të disponon,  
të galdon,  
të relakson,  
të çmall  
e të dritëron.

868. Kënga largon mërzinë, brengën,  
sëmundjen, dhimbje, të gjitha kravatat. Kënga  
shëron shpirtrat.

869. Kosovën duhet ta kemi në zemër, si vend i  
bukurive të rralla, të virgjëra, princërore e  
mbretërore.

870. Gjithnjë populli ynë, duhet të ndihet krenar  
me ata që mbëltuan tokën e Kosovës me gjakun  
e tyre.

871. Zgjidhe profesionin që e do, me atë t'i mund ta sigurosh jetën tënde.

872. Dashuria është ajo që i thotë ndal urrejtjes.

873. E kaluara mbetet kujtim, e ardhmja shpresë. Kujto dhe shpresë çdo herë gjëra të mira

874. Nëse në familje bëjmë grindje, ankesa, shpifje, gënjeshtër a përgojime, së pari ia shfaqim vetes një çmim të ulët, pastaj familjes duke rënë në nivelin më të dobët të mundshëm.

875. Komunikimi më i mirë dhe më i sigurtë mes njerëzve, është kur ajo hapësirë ku zhvillohet biseda, ngërthen në vete atmosferë besimi dhe kënaqësie në mes bashkëbiseduesve.

876. Fjalët lënduese, e lëndojnë lënduesin sepse i ka dëgjuar herë pas here për shumë kohë.

877. Mos e lejo veten të bësh gjëra të papastrë apo të ndyra.

878. Përgjegjësia e prindërve është që të luajnë një rol aktiv te fëmijët e tyre që t'i rrisin në frymën e parimeve edukative dhe t'i bëjnë ata të suksesshëm për jetë.

879. Njeriu nganjëherë nuk ngopet nga dashuria e madhe për ata që i do.

880. Zemra e ftohtë, nuk buron fjalë të ngrohtë.
881. Njeriu pandërprerë projekton gjëra të dëshiruara.
882. Njeriu vuan aq shumë, nga frustrimet dhe nga etja shpirtërore për të arrirë sa më shumë.
883. Synimi është pothuajse plotësim i dëshirës dhe pasion i asaj që ne dëshirojmë.
884. Pendimi është keqardhje e thellë e njeriut për gabimet që i ka bërë më parë. Ajo tek personi krijon neveri ndaj veprimeve të tij, mirëpo mund të themi se është edhe një përvojë njerëzore që e mëson njeriun të pengojë përsëritjen e pareshtur të gabimeve, gjithashtu është një emocion i thellë që bren ndërgjegjen e secilit.
885. Çdo herë kur justifikojmë gjëra të pavërteta, aty mungon drejtësia dhe barazia si dy shtylla të forta të shoqërisë.
886. Dashuria është ëmbëlsi,  
mirësi, butësi besueshmëri  
e mb,i të gjitha, paqe,  
harmoni e respekt i ndërsjellë  
në mes dy personave.
887. Dashuria përfshin tërheqjen e njeriut në shumë drejtime; dashuri është kur tregojmë

interesim për personin tjetër, kujtojmë dhe fantazojmë çdo herë atë, magjepsemi nga veprimet e qenies që duam, turbullohemi nga lëkundjet e ndjenjave dhe emocioneve që kemi përbrenda nesh. tregojmë butësi, përgjegjshmëri, fisnikëri, vlerë e besim të lartë për personi.

888. Dashuria shfaq admirim, miqësi vllazërore, afeksion, kënaqësi shpirtërore. Ajo në vetëvete ngërthen dëshirë, përkushtim, forcë, entuziazëm marramendje, zhuzhuritje seksuale, butësi ëmbëlsie në mes dy të dashuarve.

889. Njeriu sipas formimit të bindjeve të tij, percepton, rishikon, korigjon pikëpamje të ndryshme, qofshin ato pozitive apo negative.

890. Për të arrirë diçka duhet punë, mençuri, guxim, vullnet, këmbëngulësi, pozitivitet, por mbi të gjitha Dashuri.

891. Njeriut i digjet trupi dhe shpirti nga gjërat negative.

892. Femrat janë ato që kanë çdo herë stil dhe pasion jete. Ato ëndërrojnë gjëra të bukura dhe të rehatshme, madje kursejnë para për t'i blerë ato kur arrijnë t'i kenë ndihen më të lumtura dhe më ekstravagante.

893. Ekzistenca e një mashkulli, nuk ka kurrfarë kuptimi as rëndësie pa një femër të bukur. Ajo është arsyeja, motivi i një jete të lumtur e të bukur.

893. Femra është zemra e dytë e mashkullit.

894. Femra është pesha e familjes, një shtëpi që se ka së paku një femër është shtëpi e shkretë, e mbyllet dhe me ferrë.

894. Në jetë njeriut i duhet Dashuria e paprekshme, e paepur e mbi të gjitha e parrënuar.

895. Gjaku shqiptar, është ai që e madhështon rëndësinë e të qenit shqiptar.

896. Zemërgjerësia e nënave dhe gjysheve tona, i kapërcen kufijtë e gjithçkaje.

897. I huaji ta jep plumbin në kokë, i yti në zemër.

898. Mos e përqesh brengën e tjetrit, mos u indinjo me hallin tënd.

899. Mos i përdorni të tjerët si trampolinë.

900. Mos u merr me përgojimet e të tjerëve, e rëndësishme është të jesh i kënaqur me atë që bën dhe të ndihesh rehat.

901. Zemra e drejton njeriun për të bukurën.



902. Dashuria është fshehtësi e njeriut, që më së miri dinë ta shpjegojnë shpirti dhe zemra.
903. Miqësia pa interes, dashuri e vërtetë.
904. Dhimbjen e dhimbjeve shkakton Dashuria.
905. Njeriut nuk i rrihet qetë, e nuk i zihet vendi vend të ketë pranë vetës atë që e do. Është sikur kur ke etje e nuk mundesh dot të rrih pa pi ujë.
906. Nuk është e rëndësishme me çka udhëtojmë, por për cilin vend jemi duke udhëtuar.
907. Për një miqësi të sinqertë, jetësore është ta duam njëri-tjetrin në mënyrë të shenjtë.
908. Lavdërojini me sinqeritet dhe përzemërsi të thellë ata që meritojnë lavdërimin e respektin e ndërsjellët.
909. Lumturi nuk i sjell njeriut largimi nga vatrat shekullore, përkundrazi i sjell vajtim dhe heshtje të tmerrshme.
910. Më qan zemra për gjërat që s'kanë shpjegim.
911. Zemra dëshiron të jetojë me ata njerëz që i ka zgjedhur të dashur përbrenda vetës. Kur i ka afër vetës, këta persona të duket se e gjithë bota është në duart e tyre, dhe lumturia nuk

mund të përshkruhet dot me fjalë. Kur zemra jonë nuk i ka pranë vetës, digjet sikur qiriu në errësi, me ç'rast ndjenjat dhe emocionet që kemi për ta, nuk njohin kufi imagjinarë. Ndjenja e dashurisë për këta persona, është aq thellë e rrënjësor në zemrën dhe shpirtin tonë, sa që lirisht mund ta quajmë humnerë të paskajshme.

912. Njeriu nuk ndihet i tëri, dhe nuk mund të frymojë lirshëm, përderisa nuk e ka pranë vetës atë që e do.

913. Të mendohet një shoqëri pa femra, është sikur të kesh një lule të vendosur në vazo, me dheun që ka përbrenda, por që nuk e ujit asnjëherë.

914. Secili njeri mbron pozitivitetin, qëndrimin, bindjet dhe pikëpamjet e tij, madje qofshin edhe të pavërteta.

915. Një gjë që e thyen njeriun shpirtërisht, është kur zhgënjehet përfundimisht nga ata njerëz që i ka dashur më shumë se dashuria, i ka pëlqyer më shumë se pëlqimi, i ka duruar më shumë se durimi, është munduar t'i gëzojë më shumë se gëzimi, i ka vlerësuar më shumë se vlerësimi jetën atyre ua ka dhuruar.

916. Nëse thua që vërtet e do një njeri, atëherë pse nuk ia do të mirën? Pse nuk e përkrah atë? Pse bëhesh qëllim –keq?

917. Nganjëherë, kur rastisim të takohemi me ca pleq, na duken se si të ishin të moshës rinore, ani pse ata fizikisht janë shumë më të plakur. Sekret i gjithë kësaj është se brenda tyre fshihet ndjenjë e thellë dashurie, respekti dhe sinqeriteti, virtyte që njeriun s'e plakin asnjëherë, pavarësisht moshës që mund të ketë.

918. Të kesh kujdes, mirësjellje, sinqeritet ndaj femrës, është akt i shenjtë. Akt, ky, i njerëzve me virtyte të larta njerëzore, dhe i njerëzve me mjaft ndikim e peshë në shoqëri.

919. Femrën vërtet e bën të duket bukur dukja e jashtme, por një gjë që e bën të ndihet e veçantë nga femrat e tjera, është eleganca e saj në shpirt.

920. Dashuria e shenjtë duhet të vdesë veç në varr.

921. Përvoja është ajo që nuk po mbërrin fill në cak të njeriu, gjithnjë arrijnë me vonesë. Ah, sikur të kishim përvojën që nga fillimi, ndryshe do t'i shihnim dhe ndryshe do të dilnin gjërat!

922. Dashuria dashurinë e dyfishon dhe më shumë.

923. Njerëzit që na pëlqejnë, nuk është veçse i duam. Vetja jonë ka nevojë t'i ketë çdo herë pranë, shpirti ndihet i etur përbrenda kur nuk i ka afër. Pa praninë e tyre, ne jemi një asgjë që zvarritet përtej hiçit e jo ndryshe.

924. Për një jetë të lumtur, dashuria duhet të jetë gurthemeli.

925. Njeriu e do nxehtësisht, qenësisht, çiltërsisht atë që i fshihet në shpirt.

926. Të duash një person, dhe të të dojë, është njëlloj sikur t'ia shfaqësh lumturinë tënde atij dhe anasjelltas.

927. Personat që në jetën tonë, kanë qenë më me ndikim, nuk harrohen asnjëherë. Përkundrazi na shfaqen çdo ditë e më tepër në kujtesë.

928. Jeto në të tashmen, e kaluara s'ndryshon gjë, por mund të na mësojë në mospërsëritjen e gabimeve në të ardhmen.

929. Dëshirat e juaja janë këmbëngulje drejt suksesit.

930. Njeriu pa qëllim, është njëlloj sikur gjethet e drunjve kur bien në tokë, i merr era herë andej e herë këndej.
931. Gjëja e vetme, që na zbukuron jetën, është arritja e qëllimit.
932. Njeriu, çdo mëngjes kur zgjohet, duhet për t'i thënë vetës : “Athua ç'të bëj sot, diçka të mirë?”
933. Të jetosh me ata njerëz që i ke për qejfi, është aktivitet shlodhës i shpirtit që të dhuron kënaqësi pa masë.
934. Përplot mund të duan sa unë, por asnjëri si unë.
935. Bëhu mirëdashës, e jo keqdashës.
936. Çdo ditë e kaluar, e jetës sonë mbetet një kujtim. Çdo kujtim në vete mbush ditarin me histori kujtimesh.
937. Sekret i lumturisë është të kesh një ambient të ngrohtë në familje.
938. Për gjëra të mëdha njeriu nuk ka fjalë as shprehje se si t'i shpjegojë.
939. Sa keq (mjerisht) që gjërave të rëndësishme po u humb rëndësia.
940. Nuk duhet dhe nuk mundemi t'ia fshijmë askujt pafytyrësitë e bëra.

941. Mos e ndihmo dike duke goditur tjetrin. Ai është sulmi më i rëndë që u bëhet të dyja palëve.

942. Sikur të kaloja unë në përgojimet e thashethemet e ulëta, nuk do të arrija deri këtu.

943. Pa ty trupi im trung i përplasur mbetet.

944. Njeriu ka dy etje në shpirt :

1. Të pi ujë atëherë kur ka nevojë,

2. Të ketë pranë vetës atë person që shpirti ynë të ndjehet i etur, kur s'e ka pranë.

945. Për atë që e dua marrëzisht, jetoj dynjerëzisht.

946. Goja mu tha si eshkë, s'mund të flisja më as edhe një fjalë.

947. Vetëm mendjen ta kem të kthjellët, të tjerat vijnë më pastaj.

948. U mjegullova në mendime, duke të kërkuar ty e prapë s'të gjeta.

949. Mosguximi dhe mos-vetëbesimi e bëjnë njeriun të jetë dështak.

950. Gjërat e këqija dhe të pa vlera, e mendojnë njeriun deri në stërmundim.

951. Shumë i zbrazët është në shpirt ai njeri që nuk ka brenda vetes zjarr kujtimi.

952. Secili person ka të ngulitur brenda vetes spektrin e fantazisë dhe imagjinatës.

953. Njeriu është melhem i plagës shpirtërore.

954. Një njeri i besueshëm, duhet të jetë psikolog i sinqeritetit dhe interpretimit të fjalës.

955. I miri asnjëherë nuk bëhet i keq nga rrethi i mirë që ka.

956. Asnjëherë mos mendo, se duke nëpërkëmbur dhe nënçmuar suksesin e tjetrit, ju mund të arrini diçka. Përkundrazi.

957. Të rënët janë fatbardhë, që qëndrojnë të pavdekshëm në zemrat e të gjallëve.

958. Çuditërisht turbullohem, kur akoma vazhdon të na vlejë thënia:” Homo homini lupus est”. -Njeriu për njeriun është ujk.

959. Më qan zemra për ca njerëz, që aq jam munduar t’u bëj të mira, sa që herë pas here ndoshta e kam harruar veten dhe familjen, duke u përkujdesur për ta. I dua ja aq ngrohtësisht, si të ishin persona të familjes apo të gjakut tim. Shpesh shihja veten se mos po teproja duke mos kursyer asnjëherë gjërat t’u jepja atyre, po në anën tjetër dashuria e thellë që më ishte ngulitur në zemër për ta, më thoshte se asgjë s’duhej të më dhimbset. E këta njerëz, nuk dinin

gjë tjetër pos këtë mega-mirësi timen ta kthenin në mosrespekt, nënvleftësim dhe urrejtje.

960. Duaje dhe respektoje nënën, është person i shenjtë në jetën tuaj, që iu ka lindur e rritur me dromca shpirti.

961. Bëhu mirëdashës, e mos e bëj veten të të thonë keqdashës.

962. Duart më të bukura nuk janë as ato të bardhat, as ato të verdhat, as të kuqet e të zezat, por janë ato që edhe të ënjtura e të çara qofshin, gjithnjë mbajnë aromë krenarie e ndershmërie.

963. Ne nganjëherë, kur kemi dikë që duam me aq vullnet e besnikëri, thuajse kemi hyrë brendësisht në jetën e tij, dhe nuk mund të ndahemi më nga ai, madje as edhe për një çast.

964. Jetoni me ata njerëz, që kur jeni pranë tyre ndiheni të kënaqur e të admiruar tejmasë. Koha, gjatë së cilës qëndroni afër tyre, ik shumë shpejt. Relaksi më i madh, i juaj shpirtëror janë pikërisht këta..

965. Ca njerëz, nuk është veçse pse i ikin drejtësisë, por në forma të ndryshme dhunojnë e përdhunojnë atë.



966. Mos prit të mira nga qëllimkeqi, në të njëjtën kohë mos i prit të mirat nga qëllimkëqijtë.

967. Mëkat që disa njerëz dobësi e kanë sinqeritetin tënd.

968. Ndonjëherë me disa njerëz, kam dëshirë të kaloj përtej të mirës. Kurse me disa të tjerë ndodh mbase e kundërta.

969. Asnjë buzëqeshje nuk është më e plotësuar, se sa buzëqeshja e mashkullit ndaj femrës që e dashuron.

970. Njeriu i vogël me shpirt të madh, mbetet përherë i madh.

Njeriu i madh e me shpirt të vogël, mbetet përherë i vogël.

971. Inati i tepërt edhe në gjumë s'të hiqet.

972. Babai pa fëmijë, bariu pa bagëti asnjëherë nuk shkon.

973. Enigmë është fati i krijesës njerëzore.

974. Secili me gjuhën e tij shikohet në pasqyrat e të tjerëve.

975. Shenjë e denjë dashamirësie dhe respekti, është kur dora e dikujt përkëdhel qepallat e tua. Por jo edhe atëherë, kur ajo bëhet false.

976. Mos lejo që rrobat e tua të stërpiken nga balta e baltaxhinjve.

977. Nëse më pyesni si jam.

Iu them : Si koha.

978. Vërtet nuk ka gjë më të rëndë, se të rrohet në robëri. Ama nuk ka vdekje më të mirë, e më të ëmbël që të vetëflijohesh për liri.

979. Nganjëherë fundi i vuajtjes nuk ka fund.

980. Shikoj mendjen e njeriut e jo njeriun Shikoj shpirtin e jo bukurinë. Nuk shikoj trupin dhe sytë, shikoj diturinë e çiltërsinë. Shikoj, shikoj guximin, trimërinë, dashamirësinë, respektin e, mbi të gjitha, Dashurinë.

981. Secili në këtë jetë e kemi mundësinë të bëjmë gjëra të mira, andaj asnjëherë mos i kurseni ato.

982. Një proverb kinez thotë :*Distant water won't help to put out a fire close at hand* (Uji që ndodhet larg, nuk do të të ndihmojë ta shuajë zjarrin që ke afër ). Ashtu edhe tek njeriu, çdo herë duhet ta japë ndihmën ai që e ke më të afërm.

983. Asnjëherë nuk ka vdekur ai njeri që për ne rron i përjetshëm në shpirt. Ai mund të ketë ikur fizikisht, por shpirtërisht është pranë nesh,

jeton me ne. Është përherë i freskët në zemrën dhe mendjen tonë , duke iu shfaqur kujtesës si nevojë, si obligim që ekрани i vetëdijes njerëzore nuk ka kah t'i largohet, edhe po deshi, pos të merret me përkëdheljen e atyre kujtimeve që janë bërë me njerëz që fizikisht kanë ikur prej nesh, ama shpirtërisht çastet që kemi kaluar pranë tyre, vetes sonë i kanë lënë gjurmë të pashlyeshme.

984. Duaj...Duaj.... Duaj...çdo ditë e më tepër që të bëhesh i dashur për të tjerët.

985. Të duash dikë, do të thotë ta dashurosh atë pa masë, të mos dhimbset as edhe një gjë për të, duke i dhuruar gjëra pa rezervë.

986. Besoni në ëndrrat që keni, asnjëherë mos i humbisni shpresat, jetoni që të arrini sa më shumë një ditë do arrini kulmin e suksesit.

987. Në këtë jetë na ndodhin aq e aq të këqija e poshtërime. Por nuk ka poshtërim e nënçmim më të rëndë, që respekti ndaj dikujt të kthehet me mosrespekt.

988. Njeriu nuk mund të jetojë pa oksigjen, oksigjeni i njeriut është dashuria. Dashuria sa më e thellë, bën që oksigjeni tek ne të depërtojë më lirshëm në rrugët e frymëmarrjes, dhe të

ndihemi më të çliruar, më të relaksuar dhe më të pastër përbrenda.

989. Edukata është ajo që duhej ndërhyrë në psikikën e fëmijës, po nuk ndërhyri edukata, fëmija asnjëherë nuk mund të kuptojë të metat dhe dobësitë e tij. Kjo paedukatë, ndikon aq shumë në normat e jetës së tij, sa që fëmija shumë lehtë mund të krijojë përshtypje armiqësore për rrethin shoqëror.

990. Çdo gjë që na rrethon, e fut kujtesën tonë në mendime, madje ca prej tyre shumë të thella, ndoshta edhe të pakapshme.

991. Suksesi padyshim, u takon atyre që përgatiten për të ardhmen.

992. Në jetën time gabova aq shumë, ndoshta edhe më tepër se vetë gabimi, por e mira e kësaj është se u pendova aq thellë më shumë se pendimi.

993. Njerëzit normalë asnjëherë nuk përdorin dhunë të rreptë psikologjike. Ata të cilët kanë cilësi të dobët morale, karakter të fëlliqur njerëzor përdorin sjellje me tendencë dhunimi, përdhunimi, abuziviteti dhe imoraliteti.

994. Populli ynë fisnik e bujar, brez pas brezi ka përjetuar gjëra rrëqethëse, lemeritëse nga më

të ndryshmet dhe më të vragët, të cilat këtij populli i kanë lënë trauma shumë të rënda, madje edhe të paevitueshme, që edhe sot brejnë e dekoncentrojnë shpirtërisht këtë popull.

995. Njeriu i shkathtë, nuk mbetet shkret.

996. Kujdes, jeta të has në të papitura dhe labirinte, deri sa të arrish cakun e dëshiruar.

997. Dashuria dhe admirimi, që kemi për tjetrin, depërton nga zemra dhe shpirti i pastër.

998. Përnjëmend do të thosha, më me vlerë njeriu të sillt mirë me ca persona, edhe atëherë kur ata sillen aq vrazhdë.

999. Veset e këqija e të çoroditura po na dërgojnë në një rrugë, dhe në një vend ku nuk ka njerëz të tjerë, përpos qëllimkëqijve, maskarenjve, idiotëve e matrapazëve, të cilët asnjëherë, dhe për asnjë moment të vetëm, nuk kishin virtyte të pastra njerëzore.

1000. Shoqëria me njerëz të dashur po na bën: më të fortë, më të lumtur, më të shëndetshëm, më jetëgjatë, më të përkushtuar e më krenarë gjatë gjithë jetës.

1001. Frekuenca e mendimeve negative, është ajo që shkatërron forcën, besimin, entuziazmin,

krenarinë, vullnetin, optimizmin, shëndetin psiko-social, me një fjalë e bën njeriun të pasuksesshëm.

1002. Tradhtari përsëri tradhton tradhtisht tradhtinë, nëse këtë gjë s'e ke mësuar që në tradhtinë e tij të parë.

1003. Ideologjitë e këqija e dërgojnë njeriun në humbje të besimit, në ankth, në mbyllje(izolim) në vetvete. Duke e trajtuar veten si person të tepërt dhe të padobishëm në rrethin shoqëror, bile shumë nga ta nuk i shmangen dukurisë së vetëvrasjes.

1004. Shpesh bëhem i padurueshëm dhe irritues me të tjerët. Ky irritim e kjo padurueshmëri, vjen më së tepërmi kur zhgënjehem nga ata njerëz që ua dua të mirën, dhe nuk kam dëshirë që asnjë e ligë t'u ndodhë atyre.

1005. Anomali e shoqërisë së sotme – alkoolizmi.

1006. Njeriu, me egoizmin e tij, po prish edhe ekuilibrin e karakterit personal që e ka.

1007. Nganjëherë më i lumtur ndihem kur ndihmoj tjetrin, se sa kur bëj diçka që më bën mua të lumtur.

1008. Shumë nga ne problemet e shumta që i kemi, i marrim me ankth dhe depresion të thellë. Andaj ne në vend se t'i zgjidhim ato, përsëri jemi duke i krijuar vetes më shumë depresion nga depresioni i krijuar. Mënyra e vetme, e zgjidhjes së problemeve dhe e brengave tona, është që të kemi :kohë, durim, punë dhe energji shtesë.

1009. Mos mendo, se e shton detin kur e hedh një kovë ujë, mos mendo se e shtjerr detin duke ia marrë një kovë ujë.

1010. Mos i krijo vetes pretekste të gabuara, mos lejo që të mposhtesh nga çdo gjë, mos ia krijo vetes dembelizmin, rehatllëkun e komoditetin e tepërt, sepse të gjitha këto të dërgojnë në humbje të kohës, dhe të bëjnë të pa suksesshëm.

1011. Të kesh fatin, që ta kesh një familje, një femër me vlerë dhe karakter të lartë njerëzor, është një pasuri aq e madhe, e cila as nuk shitet e as nuk blihet.

1012. Femra çdo herë është ajo që ka me vete elegancën, mendjemprehtësinë, butësinë në trup, në të folur dhe në shpirt.

1013. Mos ia shndërro femrës jetën në makth.  
Ajo s'e meriton atë.

1014. Pasionohu nga ajo punë që e bën, sukcesi  
i asaj vjen vet pastaj.

1015. Ah, sikur të mund të kthenim kohën  
prapa, shumë gjëra do kishin nevojë për  
përmirësime.

1016. Vërtet nuk i kuptoj disa njerëz, që  
mundohen t'i ndjekin vetëm kënaqësitë  
personale të tyre, pa i interesuar tjetri. A ndihet  
i lumtur ai njeri që nuk çmon lumturinë e tjetrit?  
Nuk mund të ndihet i lumtur.

Ai njeri, që nuk çmon suksesin e tjetrit, nuk  
mund të jetë i suksesshëm.

1017. Paqartësia e tepërt, vjen shkaku i  
mosdijes së bashkëbiseduesve.

1018. Çdokush drynin e fshehtësisë e ka të  
fshehur në zemër.

1019. Të gjitha buzëqeshjet mund t'i dua Por  
unë jam dashuruar vetëm në një buzëqeshje.

1020. Njëzet e pesë të mira ua bëj, për një të  
mirë.

1021. Asnjëherë të mos jemi nënçmues,  
poshtërues dhe lajkatarë. Po i patëm këto tri  
gjëra, ne jemi duke krijuar marrëdhënie të



disfavorshme, së pari me veten tonë, e më pastaj me të tjerët.

1022. Dashuria edhe pse nuk është art, ajo është arti më fisnik i ndjenjave dhe emocioneve të thella shpirtërore.

1023. Punë, lodhje, vendosmëri, mbi të gjitha besim e krenari – e arrijmë cakun e dëshiruar.

1024. Demotivimi është shkas që iu pengon ju në arritjen e planeve të paracaktuara. Çdo herë mundohu që vetes tënde t'i krijosh ca objektiva për t'i realizuar ato. Krijë brenda vetes pozitivitet dhe entuziazëm për suksesin që mendon se mund t'ia arrish. Mosinteresimi, mosvullneti, moskuraja iu bënë ju që të ndaleni nga qëllimet që do mund t'ia arrinit.

1025. Vlerën dhe bukurinë familjes nuk ia shton një shtëpi sado luksoze që është. Por ajo që ia shton bukurinë, hijeshinë, vlerën e krenarinë, është që brenda asaj familje të vijë një grua e mirë, e ndershme, vetëmohuese dhe punëtore.

1026. Humbja e njërit prind tek fëmija, krijon pasivitet, paimteres, habi, dhimbje emocionale e shpirtërore, humbje të vullnetit për jetë. Kjo humbje tek fëmija, ndikon në mënyrë të konsiderueshme në shëndetin psikik të tij, duke

iu shfaqur ngjarje si dhimbje, trishtim, zi, pikëllim, të cilat në imagjinatën e fëmijës krijojnë ndjenjën e frikës.

1027. E meta jonë është se shumë gjërave i presim kohë të gjatë pa ia filluar. Koha nuk na pret, ajo mbaron shumë shpejt duhet që ta shfrytëzojmë edhe një çast të vetëm që ta zëmë hapin.

1028. Ne ndihemi aq thellë të lumtur, kur punojmë për realizimin e diçkaje, që neve na bën jetën të bukur.

1029. Vetësiguria dhe përqendrimi janë shkas i arritjeve të mëdha.

1030. Mëkat që kur qemë të ri, nuk ditëm ta shfrytëzonim kohën sa duhet për gjëra me vlerë.

1031. Vetëpërmbytja dhe butësia shpirtërore, na bëjnë ne të veçohemi nga të tjerët.

1032. Pasioni i thellë që kemi për diçka, na ngacmon ne, duke na shtyrë drejt atij qëllimi.

1033. Do të vijë një ditë, që secili njeri do të shpërblehet për hakun e vet.

1034. Nuk ka gjë më të rëndë, atëherë kur armiku paraqitet kinse mik, e në të vërtetë të tradhton tinëzisht e pabesisht.

1035. Njerëzit që i duam, emri i tyre në zemrën tonë skalitet me shkronja të arta.

1036. Ne, atë që e kemi dashur më së forti, kur të prishemi me të, e urrejmë më së shumti, sepse nga dashuria aq e madhe s'e kemi pritur se do na zhgënjejë.

1037. Është vërtet mëkat, që as mos ta shikosh me sy atë person që të do me zemër.

1038. Për çdo gabim, gabim pas gabimi, njeriun e bren ndërgjegjja. Mjerë për atë njeri që se bren ndërgjegjja e tij.

1039. Kudo që të ecësh, mundohu të mbjellësh dashuri, sepse nga dashuria e dhënë largon urrejtje Me dashuri edhe armikut ia heq armiqësitë.

1040. Kudo dhe ngado bëhu vetvetja.

1041. Një femër ia rrit vlerën vetes, së pari kur nderon dhe respekton shtëpinë në të cilën është lindur.

1042. Dashuria e bijës për babanë, bëhet më e shenjtë, atëherë kur bija i çon në vend fjalët që më parë ua thoshte i ati.

1043. Të gjithë thoshin, kjo s'kalon. Po ia që kaloi.

1044. Nuk të pëlqej, po të mbaj në shpirt

Nuk të shikoj në sy, po në zemër  
Të gjithë mund të jenë të rëndësishëm  
Por ti më i shtrenjti emër.

1045. Lotët nuk mund ta shprehin mllëfin që kam për të kaluarën.

1046. Shpeshherë njeriu nuk derdh lot veç nga syri, por nga zemra dhe shpirti. Në ato momente jemi lajmëtarë të një dhimbjeje dhe të një emocioni aq të thellë.

1047. Çdo kujt ndoshta, edhe mund t'ia kthesh borxhin në jetë, por dikujt që e ke të pamundur, sado që mundohesh, janë familja. Mundi dhe sakrifica që bënë ata për ty, që nga vegjëlia e deri tek rritja jote, është i pakompensueshëm dhe nuk ka para që i kompenson dot.

1048. Nëse qëndron jashtë vendit, të vjen mundësia që ke shumë të holla, mënyra më e mirë për t'i shpenzuar është t'ia dhurosh familjes.

1049. Nderi dhe burrëria bie tek ai djalë, i cili sakrifikon babanë për grua.

1050. Asnjëherë nuk duhet thënë vetes: jam i mirë, i sjellshëm, i ndershëm, i respektueshëm, bëra këtë, bëra atë. Çdo herë duhet t'i themi

vetes sonë, unë duhet të përpiqem t'i arrijë këto cilësi.

1051. Pse, o mik, kafshon tinëzisht, t'i nuk je gjarpër helmues..

1052. Çdo kujtim nga dita –ditës mund të zbehet, po kujtimi që kemi për familjen, gjithnjë e më shumë fuqizohet.

1053. Gjuhën e urrejtjes nuk mund ta kuptojnë të gjithë, gjuhën e dashurisë e kupton secili.

1054. Sa më shumë të mira, që i ke bërë mikut, e ai t'i ka kthyer me të këqija, urrejtja për të vazhdon të rritet.

1055. Çdo kohë është e bukur, kur kalohet me dashuri.

1056. Kujdesuni, që tek fëmija juaj, të kultivohet respekti për të tjerët.

1057. Më mirë hesht. Se të grindesh në vendin e grindjeve.

1058. Mos ji arrogant, mos u sill me të tjerët në mënyrë të vrazhdë. Çdo sjellje e mirë lartëson veprat e tua, çdo sjellje e pakontrolluar dëmton imazhin dhe karakterin tënd personal.

1058. Këndshmëria nuk është asnjëherë bezdisje.

1059. Çelësi i suksesit është Besimi, dryri që e mbyll këtë çelës është Mosbesimi.

1060. Bëni gjërat, që i shihni si pasion të vetes suaj.

1061. Një fjalë e rëndë, e thënë në momentin e duhur, vret më shumë se plumbi që del nga tyta e pushkës.

1062. E vërteta e hidhur është një e pazgjidhur.

1063. Njeriu, me burimin më të lartë të etikës dhe gjenialitetit, është pa dyshim Njeriu i Singjertë.

1064. Të flasim kudo me sinjertet gjëra të sinjerta, të jemi të lirë në bisedë, të jemi komunikues dhe depërtues. Mbi të gjitha, të jemi vetvetja.

1065. Të rrugëtojmë drejt asaj rruge që na shpie në portën e suksesit.

1066. Për të arritur në shkallën e ndërgjegjësimit, njeriu duhet me doemos t'i shtyp mashtrimet e thashethemet e dikujt tjetër.

1067. Mos i kalo në heshtje, gjërat jo të mira e të shëndosha. Ato i bëjnë dëm shoqërisë njerëzore.

1068. Njeriu i shkolluar dhe i qytetëruar, nuk bie asnjëherë në grackën e të pangopshmëve, mendjemëdhenjve, trushpëlarëve, nuhatkëqijve dhe materialistëve.

1069. Mos e mbaj mllefin asnjëherë të ndrydhur në vetvete.

1070. Mos e mbroj me aq fanatizëm mendimin tënd, edhe në qoftë se është tejet i saktë. Mundësoja edhe të tjerëve të shprehin mendimet e tyre.

1071. Shumë njerëz mundohen të tregojnë sinqeritet, ama njerëz të sinqertë ka pak.

1072. Ndoshta normale do të ishte, t'ia kesh inatin dikujt që e ke më të largët, ose se ke asgjë. Mirëpo t'ia kesh inatin në zemër, dhe halë në sy suksesin atij që të do, dhe jeton me ty. Kjo gjë, do ishte një mëkat i madh

1073. I urituri kërkon kafshatën e gojës, kurse i ngopuri nuk ngopet asnjëherë, nga kënaqësia për të pasur më tepër luks të tepruar.

1074. Shpesh iu shmanga përfitimeve, që mos ta ledhatoj të keqen për qafe.

1075. Që të kesh lumturi, së pari duhet ta kultivosh atë..

1076. Nganjëherë po na u vraka mirësia e tepruar, që ia kemi bërë dikujt që fare s'e meriton.

1077. Borxhi lahet me borxh, e mira lahet me të mirë e kurrsesi me të keqe.

1078. Nuk e di si ta shpreh se sa të dua. Ama një gjë e di, më shumë se veten të dua.

1079. Njeriu para të tjerëve, mund të shtiret se kinse është i lumtur, por para vetes asnjëherë.

1080. Mos rri i kërrusur përpara çdo njeriu. Disa barten mjaft lehtë, disa të tjerë me aq vështirësi.

1081. Dashuria e zjarrtë, nuk ka ndjenja të qeta.

1082. Dashuria e vërtetë, pa keqkuptime, pa interes e gjëra të tjera, mbetet DASHURI E SHENJTË.

1083. Puthja do të ishte veç një apostrof, ndaj ndjenjave të thella në shpirt.

1084. Në muzg të ditës, në pikë të natës, në acar të dimrit, në mes të vapës, dua ty të të mbaj afër.

1085. Etja në shpirt, largohet kur të kam afër.

1086. Zemra më rreh më shumë se 100 herë në minutë, rritet adrenalina, duart dridhen nga



emocioni, sytë lëshojnë dritë vezulluese për ata që shpirtërisht i duam.

1087. I çmoj ata njerëz, që në zemrën e tyre kultivojnë urtësi.

1088. Njeriun që e rrit vlera, nuk gjendet kandar që mund ta peshojë.

1089. Athua një ditë, do t'i rikthehet mirësjellja atij?

1090. Koha neve po na ndan.

1091. Vuajtjet na shoqërojnë, kujtimet që patëm së bashku, na përqafojnë.

1092. Kërkojmë rrugicave të fatit shpëtim, a do të gjejmë athua?

1093. Dashuria shton oreksin e të qenit i dashuruar.

1094. Duke ndihmuar tjetrin, ju jeni të ndihmuar. Kur nuk e ndihmoni tjetrin, nuk jeni as vetë i ndihmuar.

1095. Mos lejo, që era kur fryn, të tundë qëllimin tënd.

1096. Njohja me gjëra të reja dhe domethënëse, zgjeron horizontin e diturisë dhe të kulturës sonë.

1097. Inati dhe nervozizmi e pëlcastin njeriun, njëlloj si zjarri gështenjën.

1098. Karakteri dhe veçantia e njeriut, shihet në respektin që bën.

1099. Bukuri e njeriut mund të jetë:trupi, fytyra, sytë, vetullat a qerpikët, kurse veçanti e tij është ideja dhe të folurit drejt.

1100. Çka njuh zemra, me vështirësi jep arsye mendja.

1101. Njeriu është duke e ndryshuar kohën, e jo koha njeriun.

1102. Njeriu i singertë është çdo herë i pasur në shpirt.

1103. Secili nga ne bën gabime vetanake. Por e rëndësishme është që çdo herë ta pranosh gabimin, dhe asnjëherë të mos e mbështetësh të padrejtën dhe të ligën. Fundja, çdo krijesë njerëzore është gabimtare

1104. Ndryshe është kur i thua dikujt diçka mirësisht e miqësisht, se sa kur e urdhëron verbalisht e rreptësisht.

1105. Mundi dhe përpjekja janë udhë e gjatë, por cak mjaft i rëndësishëm i arritjeve të larta kulminative.

1106. Gjuha e ashpër, nxitëse, therëse dhe urryese, nuk duhet të ekzistojë tek një shoqëri, e cila ka përmasa edukuese dhe qytetëruese.

1107. Dembelizmipo bëhet shkas i humbjes së kurajës dhe shuarës i ëndrrave shpresimtare tek njerëzit.

1108. Gjithnjë shndërroni punën në vullnet, ajo do kryhet me sukses pastaj.

1109. Duhet që t'i japësh vetes urdhër për të arritur dëshirën që ke.

1110. Mundohu të kesh siguri unike në vetveten tënde.

1111. Njeriu është dizajn, për atë gjë që ka talent.

1112. Lehtësia nuk sjell asgjë, vështirësia sjell sukses.

1113. Ringritu, edhe pas gjithë asaj furtune.

1114. Frekuenca e mendimeve negative, sjell çdo herë përjetime të pakëndshme, të cilat na pamundësojnë entuziazmin, gëzimin, krenarinë, optimizmin, ngazëllimin, mirënjohjen e, mbi të gjitha, vetëbesimin, duke na "dhuruar" si produkt negativitetin.

1115. Jo çdo herë mund ta duam vërtet dikë. Dashuria e vërtetë, e thellë, e zjarrtë, shpirtëruese, drithëruese, emocionuese, pa interesa, depërton përmes shpirtit dhe zemrës së pastër.

1116. Së pari duhet të jetojmë Njerëzisht, e më pastaj Kombëtarisht.

1117. Kemi shumë nga rastet, kur njeriu ndjehet i zbrazët shpirtërisht. Kjo ndjenjë mërzie na shkakton pasiguri, ngushti, padobishmëri, pesimizëm, vetëlëndim, vetizolim, mospërkrahje, humbje të arsyes, vullnetit, energjisë, durimit, zemërimit, ngurrimit, koncentrimin, të cilat na shpien deri tek gjërat më të këqija e më të vragta, siç janë depresionet e thella dhe vetëvrasja.

1118. Çdo ditë ëndërro imazhin që dëshiron ta kesh.

1119. Nuk mjaftojnë falënderimet ndaj Krijuesit të plotfuqishëm.

1120. Një kujtim i bukur kujtohet gjithë jetën.

1121. Nuk ka asnjë lloj vlere grimi i tepërt i trupit dhe bukuria e jashtme fizike, kur brendësia e shpirtit dhe e zemrës është e shëmtuar dhe e vrazhdë.

1122. Nuk je ti, është hija jote.

1123. Mirësinë e treguar ndaj të tjerëve e kemi për vete.

1124. Pse mor njeri, ia humb vetes vlerën?

1125. Sa më i drejtë që je, aq më shumë dobësi ke.

1126. Fjalët e pasura e punët e varfra, nuk bëjnë.

1127. Besimi në KRIJUESIN ma forcon vetëbesimin.

1128. Që nga vegjëlia e deri më sot, ndihem krenar që besimin në Zot e kisha të rrënjosur thellë në shpirt.

1129. Përvoja, ndjenjat dhe preferencat ndikojnë jashtëzakonisht në mendjen tonë të hapur.

1130. Besimi në KRIJUESIN, vetëbesimi në vetvete dhe këmbëngulja, janë arritje drejt krijueshmërisë.

1131. Zemra e gjanë, krejt dynjanë e fiton.

1132. Fjala e matur me karar, asnjëherë nuk sjell zarar.

1133. Asgjë nuk të kushton, respektoje të vjetrin.

1134. Heshtja për të mençuri gjithnjë është përgjigje.

1135. Më mirë herët pendimi, sesa dikur gjykimi.

1136. Mos të na humb morali, kultura edukata.

1137. Mend po na japin, në fakt nuk posedojnë për vete.

1138. Nëse ndokush në këtë botë, urren fjalët e pista, të ndyra dhe mallkuese Ai jam unë që i urrej më shumë se urrejtja.

1139. Ndoshta nuk jam aq i mirë, por çdo herë përpiqem të bëj gjëra me vlerë ,të cilat na bëjnë krenar në çdo hap.

1140. Ata që vuajnë më shumë, ankohen më pak..

1141. Njihe të kaluarën, puno për të ardhmen.

1142. Me faj tëndin tjetrin mos e fajëso. ZOTI I MADH është ai sheh çdo gjë.

1143. Mos të na mashtrojë kajtja (lakmia) e keqe.

1144. I mençuri dhe budalla të dy të mbushin mend. Por njëri me mençuri e tjetri me budallallëk.

1145. Nuk ka gjë më të shtrenjtë dhe më të shenjtë se të jesh besimtar i devotshëm.

1146. Goja gënjen, por shpirti dhe zemra kurrsesi.

1147. Gjëja, e cila më ka bërë të fortë, është besimi, i cili ma ka forcuar vetëbesimin.

1148. Vërtet një gjë e keqe kur të ndodh, edhe pas saj të dalin dhjetë gjëra të mira, ajo prapë nuk harrohet.

1149. Lum ai njeri, që dashurinë ndaj Zotit dhe familjes e ka të shtrenjtë, të pavdekshme dhe të shenjtë.

1150. Nuk duhet gjithherë, që të jemi cinikë dhe kureshtarë për gjithçka.

1151. Mbarësia i takon atij që ushqehet me BESIM.

1152. Keqbërja u takon Keqbërësve..

1153. Zot i madh, na largo nga vetja jonë, gjërat që zemra dhe shpirti i urren, e nuk i do.

1154. Çdo shtëpi është si vend i shenjtë. Andaj mundohu t'i falësh virtyte të mira asaj.

1155. E keqja të kap në kthetër.

1156. Molla është e ëmbël, po nuk hahet pa u pjekur.

1157. Ruaju ku s'ia vlen, se të mallkon e mira jote.

1158. Mos u bë i mbuluar me marre, e i mveshur me dallavere.

1159. A di me ba mirë pa kurrfarë lloj interesi?

1160. Shumë njerëz nuk dinë sa peshojnë, pse kanë ardhur në këtë botë, pse jetojnë..

1161. Dikush shkel në para, dikush ende në baltë.

1162. Ka njerëz që njëherë mos me iu gjetë, krejt të mirat t'i harrojnë.

1163. Kur plas e hidhëta, nuk të lë të qetë.

1164. Mendja thotë shuaj, po zemra pëlçet.

1165. Mos iu mburr dikujt, që ke bërë një mirësi. Të tjerët duhet të mburren me ty, jo i me veten.

1166. Njeri i vlerave, është ai, i cili, edhe pse i nevrikosur, vepron qetë e me drejtësi.

1167. Zhgënjimi më i madh ndodh kur nuk presim nga ai që deri dje ia bëmë dhjetë të mira, e ai le që nuk është falënderues e mirënjohës ndaj neve, po përkundrazi i hedh në greminë ato.

1168. Edukata, mirësia dhe urtësia- tri shtylla që njeriun e bëjnë të veçantë dhe e largojnë nga çdo e ligë.

1169. Në ditët e sotme, brenda një fytyre fshihen shumë fytyra.

1170. Edhe ca krimba të vegjël brejnë një lis të tërë..

1171. Qëndro në natyrshmërinë që ke, bëhu i ndershëm, i sigurt, i sjellshëm dhe unik..



1172. Me besim gjendet rrugëdalja e çdo problemi.
1173. Skamja është aq e rëndë, sa që e dredh dhe hekurin.
1174. Gjërat që reklamohen për ditë, u humb vlera.
1175. Dikur burrëria, sot pabesia  
Dikur premtimi, kurse sot mashtrimi
1176. Kur gëzimi ndahet me të tjerët, shtohet dhe më tepër volumi i tij.
1177. Dashuria që kam ndaj teje Krijues, më bën më të fortë se çeliku.
1178. Testamenti më i mirë për njeriun e singertë, është FJALA.
1179. GURBETI –dhëmbja që s’na u ndal, plaga e pashëruar.
1180. Falja është thjeshtë, një mënyrë për të vënë shpirtin tënd në qetësi dhe të bën të ndihesh "rehat".
1181. Kur jam pranë teje, vullneti dhe shpresa ime për të jetuar shtohet çdo orë dhe çdo minutë madje.
1182. Dashuria është e vetmja ajo që largon dhembjen e dhimbjeve.
1183. Dashuri e vërtetë është puthja në shpirt.

1184. Dashuria është e vetmja që të bën të kesh botën në duart e tua.
1185. Zemra mund të harrojë, por jo edhe atë që e do nxehtësisht.
1186. Njerëzit ikin.... Por dashuria mbetet.
1187. Njeriu nuk fyhet veçse nga fjala, por edhe nga shikimi.
1188. Tek gënjeshtari fshihen shumë fytyra.
1189. Çdo herë, dhe në çdo kohë, përpiku të reflektosh energji pozitive në shoqëri.
1190. Mos qesh për dështimet e tjetrit, por qaj për të pa arriturat e tua.
1191. Aroma e dashurisë ndjehet, nuk blihet.
1192. Dashuro dashurinë që të bëhesh i dashuruar.
1193. Ka vite që i harroi koha, ka çaste që ia vlen jeta.
1194. Për turpëruesin turpësia po u hëngërka me bukë, pa u skuqur fare madje.
1195. Lum ai që në autorësinë e tij ka nder, sinqeritet e jo paturpësi, negativitet e djallëzi.
1196. I kam neveri ata njerëz që në sy tregohen shumë të dashur, të kujdesshëm e shpirtmirë, kurse pas shpine gjithnjë janë të veshur nga naiviteti dhe dashakeqësia.

1197. Dashuria ka vlerë sa vetë jeta, sepse jeta është e zbrazët pa dashuri.
1198. Çdo njëri, që urren vlerat, mbetet i pavlerë.
1199. Fajëso veten, që nuk dite ta vlerësosh realitetin.
1200. Fatbardhë janë ata që jetojnë pavdekësisht të pavdekshëm nga pavdekësia e veprave të tyre.
1201. Butësia, afërsia, burrëria dhe njerëzillëku lindin, nuk mund të fitohen.
1202. Ka shumë gjëra të ëmbla, por ndër më të ëmblat është dashuria, e cila ëmbëlzon më tepër se ëmbëlsia.
1203. Dashuria shkruhet nga fjalët, por buron thellë nga zemra dhe ngrohtësia e shpirtit.
1204. Pasuria nuk të bën të dashur, por dashuria të bën të pasur.
1205. S'ka gjë më të sinqertë se dashuria e vërtetë.
1206. Dashuria ka efekt qetësues në trup e mbi të gjitha në shpirt.
1207. Gjithnjë lundroni mbi valët e dashurisë, aty fshihet lumturia.

1208. Një shtëpi e lumtur është kur secili anëtar toleron tjetrin të japë mendimin, opinionin dhe gjykimin e tij, pavarësisht nëse mendimet e tyre bien ndesh mes njëri-tjetrit.

1209. Dy gjëra kyçe për një dashuri jetëgjate janë: falja dhe mirënjohja.

1210. Vështirë është të duash dikë, që nuk ndjen admirim për të.

1211. Ujërat e qeta janë më të thellë se ujërat e rrëpishëm.

1212. Mos lejo që humbja e shpresës, të ndrydh, gjunjëzojë e demoralizojë ty për të arritur në cakun e dëshiruar.

1213. Vocërrakët, lavdërohen me punë të vockla.

1214. Interesi, ushqim i vazhdueshëm i interesxhinjve.

1215. Aset njerëzor, të duash dhe të respektosh fëmijën.

1216. Jeta – fuqi, dobësi, mundësi dhe rreziqe.

1217. Një gjë që nuk arrita ta kuptoj, është se kafshët qëndruakan më besnik se besnikëria e shumë njerëzve.

1218. Poshtërsia në çdo mënyrë, nuk lejohet kështu bre bir.

1219. Unë e di, dhe t'i e di fyerja e vëllait është nënçmim.

1220. Lehtë është vëllain me thirr shka, por dije se një gjak me të e ki.

1221. Mos më pyet si jam, kur e di se si ndjehem.

1222. Pa ty ndjehem bosh,  
pa ty s'jam i tëri,  
pa ty s'më kalohet jeta,  
pa ty ndjej mall e zjarr zemre,  
pa ty shpirti ndjehet i zbrazët  
duke shpërthyer nga dufi.

Pa ty ndjehem i humbur,  
pa ty ndjej lodhje, humbje të vetëkënaqësisë.

Pa ty ndihem i etur,  
si në një vend të largët të botës së tretur.

1223. Zemër ngurtë u bëre, ike kah lakmia,  
përtace do mbetesh se kuptove ç'është dashuria.

1224. Kur rrjedh lot nga syri, mund të mos jetë e vërtetë,  
kur rrjedhin lot zemre dashuria është e sigurtë.

1225. Dashuria ka një emër, që skalitet mu në zemër.

1226. Burimi i thellë i dhembjes, çdo herë buron lot shpirti.

1227. Duan që të ma vrasin dashurinë, duke më ofruar vetminë.

1228. Një dashuri mund edhe të përfundojë, por ndjenjat e saj mbesin përherë të përjetshme dhe të pavdekshme.

1229. Zemra ime pa ty, ndahet në njëqind copëza të imta.

1230. Lot në sy i ke dëshmi, se ky shpirt të ndjen veç ty.

1231. Fjala më ëmbëlzuese e jetës, përbëhet nga 5 shkronja –Të Dua.

1232. Puthja është zjarr shpirti për dy të dashuruar.

1233. Kur dashuria është e singërtë, brenda saj assesi nuk mund të ketë paragjykime, urrejtje, mashtrime e mendjemadhësi.

1234. Jeta ime nuk ka asnjë lloj kuptimi, kur t'i nuk je e pranishme. Acar e borë e ftohtë ndihet zemra dhe shpirti kur nuk të ka afër. T'i je e vetmja ajo që më shkrin këtë acar të ftohtë që ndjej përbrenda.

1235. Mundësisht mos fle pa dashuri, kur të zgjohesh, zgjohu me dashuri, kudo dhe ngado të kesh Dashuri.

1236. Mos kërko bionden, zeshkanen, sykaltëroshen, syzezën, kërkoje të dëlirë dashnoren, që flet pak e dashuron shumë.

1237. Nga shikimi yt i ëmbël ndjej qetësinë, lumturinë, ngrohtësinë e shpirtit.

1238. T'i je ëndrra që më zgjon, je bukuria që shpirti pa të s'jeton, je drita e diellit dhe vetë jeta për mua.

1239. Mos e vraj një shpirt që për ty qan, mos e helmo një zemër që për ty jetoji, të deshi pafund, më shumë se dashuria të dashuroi.

1240. Çdo herë kur të shoh, je ajo që më shfaq kujtimet e afsheve të zjarra të Dashurisë.

1241. Dashuria ndjenjë e thellë njerëzore, intensive, shkas i simpatisë, pranimit apo pëlqimit reciprok njerëzor në mes dy të dashuruarve.

1242. Dashuria është çelësi i zemrës, që nuk gjendet dry që mund ta hapë.

1243. Dashuria, vret zemrat e të dashuruarve.

1244. Gjithkush dhe gjithçka duket e varfër, e humbur dhe e shkretë kur nuk të kam pranë.

1245. T'i mbete ajo që më pëlqyeka më shumë se pëlqimi, t'i ishe ajo që më bëre të di ç'qenka simpatia. Me Ty tani e kuptoj, si qenka Dashuria..

1246. Shpirti i lodhur loton, kur nuk e ka pranë Dashurinë e Zembrës.

1247. Shpirti ka etje, kur nuk sheh buzëqeshjen tënde, nuk sheh qerpikët, vetullat, flokët, nuk ndien zërin e ëmbël dhe të ngrohtë nga një gjuhë e thellë dashamirësie. Ndjen humnerën e zbrazëtisë, përmallimin, sylotlargimin, pa bindjen dhe vetmimin.

1248. Me ty më qeshte zemra edhe në atë moment kur kisha lëndime, me ty më ecte koha, pranë teje më ikte jeta, e pyes zembrën time më thotë kjo qenka dashuri e vërteta.

1249. A ka më kënaqësi se kjo fjalë: D+A+Sh+U+R+I.

1250. Njeriu në këtë jetë, nganjëherë lodhet duke udhëtuar me kilometra, vetëm e vetëm të shohë atë person që e do, por prapë zhgënjehet, sepse ajo që e do, nuk bën as edhe një hap drejt tij. Ky prapë, i lënduar vrapon pas saj, e ajo assesi nuk kthen kokën nga mendjemadhësia e mosrespektimi që ka, as t'i



flasë madje. Por përse padrejtësi qenka jeta, a mos njerëzit janë të padrejtë?

1251. Qejfi dhe dëshira e mundin arsye.

1252. Rëndësia e Femrës në familje është jashtëzakonisht e madhe, femra ka rol kyç edukativo-arsimor në emancipimin e fëmijës. Ajo mbetet faktor relevant në rregullimin e harmonisë në familje dhe shoqërisë në përgjithësi, familja nuk ndihet e ekuilibruar në administrimin e punëve pa pjesëmarrjen e femrës. Ajo mbetet roli dhe pesha më e rëndësishme dhe më e shenjtë e saj. Nga kjo që thamë, padyshim, përpos femrës, askush nuk mund të merret me këtë veprimtari. Femra është çdo herë po ajo, që me punën e saj formon një shoqëri kualitative, dashuria dhe kujdesi që bën ajo për fëmijën është parakusht për jetën dhe nevojat e tij. Puna dhe veprimtaria e shumanshme që e bën femra, pa dyshim mbetet krenari dhe nder për sendërtimin e qenies njerëzore në përgjithësi.

1253. Një shtëpi duket të ketë një femër besnike, serioze, vetëmohuese, tolerante, të thjeshtë dhe mikpritëse.

1254. Monedhat me vlera të mëdha, shpesh merren të pamerituara nga duart e pista.

1255. Ka shumë nga rastet kur karakteri i gruas, është më i fortë se i shumë burrave.

1256. Kur të shoh ty, më shtohen disponimi, shëndeti, gjendja emocionale rritet, ngase e kam të koncentruar shikimin ndaj teje dhe syve të tu. Bebëzat e syve më lëshojnë dritë vezulluese dhe njëkohësisht hapen më shumë nga dashuria që ndjej për ty.

1257. Madhështia e shpirtit mund çdo bukuri fizike.

1258. Edukata e prindërve ndaj fëmijëve është parakusht themelor për suksesin e tyre në shkollë dhe në jetë. Fëmijëve medoemos u duhet që çdo herë të kenë prezencën, këshillat dhe kujdesin e prindërve. Sa më e madhe të jetë kultura dhe edukata ndaj tyre, fëmija do t'i ketë gjasat më të mëdha të riaftësohet, të dijë dhe të mësojë gjëra të mira dhe të drejta. Po ashtu pjesëmarrja e prindërve në edukimin e fëmijëve është me peshë dhe me rëndësi të veçantë për mirëqenien e gjithë familjes. Moskujdesi dhe mosedukata e prindërve ndaj fëmijëve, bën që fëmija të ketë sjellje të këqija në familje, shkollë

e shoqëri, duke zgjedhur udhëzime të këqija, të krijojë probleme dhe duke u bërë vartës i gjërave të kota dhe të padobishme, të cilat nuk i sjellin asgjë më shumë se trishtim.

1259. Koha ik më shpejt, atëherë kur bën dashuri.

1260. Më të rrezikshëm janë ish miqtë se sa armiqtë, sepse atë që ta bën ish miku, s'e pandeh asnjëherë as nga armiku.

1261. Personat e veçantë janë ata që i takon rastësisht, ama i do shpirtërisht e nxehtësisht.

1262. Në jetë mos nënvlerëso as mbivlerëso askënd, secilit tregoja mundin dhe hakun që e meriton.

1263. Nuk i dua ata njerëz që veç për halle e interes bëhen kinse të duan dhe të çmojnë, kurse më vonë ndërpresin atë interes-miqësi që patën.

1264. Shpeshherë lotoj mijëra herë më shumë se loti në sy.

1265. Sa keq njerëzit, 99 të mira t'i hedhin në koshin e mbeturinave, nëse nuk ua bën një të mirë.

1266. Pse, mor njeri, zemrën e bardhë e bën të zezë! Në vend që të bëhesh më i miri mik, nga

dashakeqësia dhe urrejtjegërryerja, bëhesh që të të them armik.

1267. Nëse nuk ke çfarë të bësh, atëherë ndihmoje dikë të afërm shokun, fqinjin, dikë që ka nevojë, dhe gjendet duke përjetuar situata apo momente të vështira. T'i bësh dikujt nder, dhe ta bësh dikë të ndihet i lumtur nga mirësia jote, të bën edhe ty të ndihesh mirë për vete.

1268. Jepi vetes pushim dhe relaksim, mendo për gjëra kreative, janë po ato që balancojnë trupin dhe mendjen dhe njëkohësisht kthjellojnë mendimet.

1269. Mos u bëj asnjëherë vulgar i gjërave dhe nofkave të këqija për të tjerët.

1270. Butësia, syëmbëlsia, mirësia, ndershmëria, respekti dhe dashuria e bëjnë një femër të ndihet përgjithmonë e bukur

1271. Një varfanjak mund ta bësh të pasur, një të pasur assesi nuk mund ta pasurosh me lumturi.

1272. Koha kalon me kalimin e kohës, andaj përqendrohuni në gjërat që mund t'i ndryshoni.

1273. Kush kërruset në rini, mbetet ashtu edhe në pleqëri.

1274. Puna, ndershmëria dhe sinqeriteti, janë ato që e lartësojnë një njeri. Inati, mendjemadhësia, mosbesimi e fundosin atë.

1275. Në këtë jetë, deri sa të vdesim, jetojmë duke gabuar nga gabimet.

1276. Sado që të ketë pluhur, nuk e njollos atë që punon me ndershmëri.

1277. Njerëzia, shpirtmirësia dhe dinjiteti, janë po këto tri shtylla që të dallojnë nga të tjerët.

1278. Shpërblimi që ju ua bëni të tjerëve, iu bën ju të ndiheni gjithnjë të shpërblyer nga lumturia.

1279. Vetëm dashuria është ajo që të jep vullnet jete dhe energji të pashtershme, të bën që t'i largosh nga vetja vuajtjet, mllëfin dhe dëshpërimin.

1280. Një dashuri nuk mund të jetë efikase, nëse në mes të partnerëve nuk ekziston besimi.

1281. Ne duhet të lirohemi nga ndotja e urrejtjes dhe përbuzjes shpirtërore që kemi për tjetrin.

1282. Çdo herë ke kujdes, të ruhesh nga gracka e inatosjes.

1283. Më e mira nga gjithë të mirat, të largohemi nga të këqijat që t'i afrohem më afër të mirave.

1284. Vdekja më e rëndë nuk është ajo që vdes trupi, por kur të vdes shpirti.
1285. Loti që del nga humnera e shpirtit, është dëshmitari më i mirë i dashurisë që ke për dikë.
1286. Drejtësia i qet pislëqet në krye (breg).
1287. Çdo herë lumturia e shpirtit është ajo që i bën dritë jetës.
1288. Ndjesia e njeriut, për të qenë i sinqertë, duhet të jetë e ngulitur në zemrën e secilit.
1289. Një artist mund të plakët e të rrudhosët, sikurse gjithë të tjerët, ama në shpirt mbetet i ri gjithnjë.
1290. Sado që të jetë, bukuria fizike nuk mund ta fshijë imazhin dhe karakterin tënd që e ke “gjarpër helmues”.
1291. Para të pa mençurve, nuhat-këqijve, gjithnjë ndihesh i nënçmuar nga budallallëku dhe gomaria e tyre.
1292. Interesxhijtë çdo herë ushqehen me ushqimin e interesit.
1293. Thashethemet dhe shpifja nuk bëhen nga askush tjetër, pos atyre që e kanë arrogancën, negativitetin dhe injorancën në shpirt.
1294. Njeriu gjatë gjithë jetës së tij është i prangosur nga prangat e jetës.

1295. Kur vërtet e ndjen një femër, brenda vetes tënde shfaq aortë tundimi.

1296. Disa vërtet ndjejnë turp të dalin në qytet me prindërit e tyre të moshuar, ama ka edhe prej atyre që do jepnin gjithçka që kanë, vetëm e vetëm t'i takojnë edhe njëherë, të flasin, të ngazëlleshen, qoftë ajo edhe çast i vetëm.

1297. Nënë - N –Nder, Ë-ëmbëlsi, N-ngrohtësi, Ë-ëndërr e bërë realitet.

1298. Askush s'e trondit dhe torturon njeriun më shumë se dyshimi.

1299. Zemërgjerët dhe besnikët gjithnjë jetojnë me zemërgjerësi.

1300. Femra kërkon vigjilencë në dashuri.

1301. Njeriu ka nevojë më së shumti për qetësi shpirtërore.

1302. Mjafton një puthje ndaj teje, të më qetësojë shpirtin.

1303. Prindërit janë të vetmit ata që nuk heqin dorë asnjëherë ndaj fëmijëve, madje edhe kur ata i lëndojnë rëndë.

1304. Pajtohu me ata që ke zënka, jeta është shumë e shkurtër, një ditë kërkon t'i shohësh, por mund të jetë vonë pastaj.

1305. Më i varfër është ai, që, edhe pse ka, me të tjerët nuk i ndan.

1306. Jeta do të ishte ndryshe, po të na jepej shansi i dytë Ah. Sa keq, që jeta nuk na ofron këtë mundësi.

1307. Sekondë. Minutë, Ditë. Javë. Muaj. Vit,. Dekadë. Shekull.... Ikën jeta.

1308. Degët ndoshta edhe mund të thahen, por trangu mbetet.

1309. Në ujë të turbullt mos u fut, edhe në qoftë se di not.

1310. Muskuldobëti mund të jetë edhe më i fortë se ç' mendon.

1311. Dhimbja më e madhe nuk është t'ia drejtosh tjetrit shigjetën, por t'ia drejtosh vetës.

1312. DUAJ, sepse mundësia për të bërë këtë gjë, ndoshta edhe nuk mund të të vijë.

1313. Lotët e derdhur kthjellojnë shikimin, ngrohin dhe zbusin zemrat.

1314. Një familje të harmonishme dhe të bashkuar, nuk del armik që mund ta shkatërrojë.

1315. Nuk duhet të mbrohet diçka, e cila është e ndaluar të mbrohet.



1316. Bëj çudi, kur kafsha kafshën e ndihmon, kurse njeriu –njeriun e kafshon.
1317. Familja dhembjen largon, gëzimin dyfishon.
1318. Bashkëdyzimi i talentit me punën, sjell sukses të dobishëm.
1319. Dështimi vjen lehtë, kur zgjidhja është e shpejtë.
1320. Lisat e rinj nuk mund të bëjnë hije sikurse i vjetri.
1321. Zhvishu nga virtytet që të bëhesh i papastër.
1322. Pushtetarët e korruptuar nuk kanë se si të jenë njerëz të ndërgjegjësuar.
1323. Maska edhe mund ta fshehë fytyrën, por as edhe një herë karakterin.
1324. Vendimet e mëdha merren nga njerëz të mëdhenj.
1325. Ka nga rastet kur shoh përtej zisë.
1326. Mos shpif, se shpifja bëhet nga shpifësit, që kanë të vetmin qëllim: shpifjen.
1327. Brenga depërton në palcë të eshtrave.
1328. Femrat shqiptare janë të bukura, të ndershme, të respektueshme dhe po aq intelektuale.

1329. Pse sot, urtësinë po e merr era.
1330. Përpjekja është vetë zgjidhja.
1331. Mos bukuria fizike nuk është shëmti, shëmti është mendja e keqe dhe sjelljet e këqia.
1332. Në buzët e femrës hije ka vetëm buzëqeshja.
1333. Të na japë motiv shpresa, mos të na harrojë harresa.
1334. Njerëzit me motiv të lartë, nuk lënë as edhe një çast koha t'i shkojë pa dobi.
1335. Mungesa e dashurisë, tek njeriu, është sikurse nga katër stinët e vitit të mos jetë pranvera.
1336. Dashuria nuk është veçse dëshirë, por edhe obligim që shpirti kërkon në mënyrë të detyruar ta ketë.
1337. Teprica mund të ketë gjithkund, përveçse në dashuri.
1338. Njeriu, për ta sfiduar jetën, duhet të ballafaqohet me të pamundurën, frikën, dobësitë dhe me gjithçka tjetër që i del përpara, ngase vetëm në këtë mënyrë mund t'i realizojë ambiciet dhe idealet që ka në shërbim të vetes dhe shoqërisë.

1339. E habitshme, se si një buzëkuq i jep formë buzëve, por jo bukuri fjalëve.

1340. Athua, pse koha po ikën, sikur të digjet një letër!

1341. Mundëso, që tjetri të kënaqet se të ka mik.

1342. Mos afirmo dosido mendimet tuaja, jepja edhe tjetrit mundësinë të thotë ç'ndjen..

1343. Një gjest, sado i vogël mirësjelljeje, iu bën të veçantë tek të tjerët.

1344. Ani pse nesër diç tjetër presim, ndonëse të njëjtat mundime do t'i kemi.

1345. Nga kjo që pashë, të jesh njeri qenka më së vështiri.

1346. Bukuria nuk janë flokët, lëkura, hunda, sytë, vetullat dhëmbët... Bukuria është plaga që ka rënkuar dhe do rënkoj, buzëqeshja, thjeshtësia, sinqeriteti, rrudhat e kohës që jeta t'i lë.

1347. Sa e habitshme, kur në shtëpinë luksoze nuk gjen ngrohtësinë familjare, që, si rrënjë, e ka dashurinë.

1348. E çuditshme, kur njeriu krenohet me diçka, prapë kjo nuk e bën origjinal.

1349. Sa çudira ka kjo jetë, ajo që më pëlqeu dikur, sot mund të mos ketë vlerë.

1350. Mos u bëj grindavec ndaj tjetrit, ka të tillë që pikërisht këtë e kërkojnë.

1351. Mirësjellja dhe respekti janë shenja të një edukate të drejtë.

1352. Jeta është e mbushur përplot e përplot gjëra të imta, të cilat dinë të sjellin probleme të mëdha.

1353. Shpesh çiftet bashkëshortore, nga një mosmarrëveshje e vogël ose nga një gjest i parëndësishëm, shuajnë një dashuri të zjarrtë që ishte më parë.

1354. Gruaja e ndershme është çelës që hap çdo dry, dhe pikërisht nga ajo buron ideali i lumturisë në familje.

1355. Aftësia, përkushtimi dhe kujdesi, fshihen pas një femre.

1356. Mos nxit injorancë dhe pabarazi në familje, për hatër të harmonisë që ke pasur deri tani.

1357. Asnjëherë nuk duhet quajtur femrën të dobët dhe inferiore ndaj punëve që mund t'i kryej një mashkull.

1358. Femra është ajo, që, numerikisht, përbën gjysmën e shoqërisë njerëzore, dhe edukon gjysmën tjetër, padyshim meriton respekt e mirësi të veçantë.

1359. Femrat ndër shekuj kanë treguar se mund të jenë udhëheqëse të zonja, edukatore të vëmendshme dhe shkencëtare të spikatura.

1360. Njerëzit mund të kenë veshje, ngjyrë të lëkurës, madhësi të trupit ndryshe prej shumicës, por këto tipare përcaktuese, nuk e bëjnë njeriun të jetë më i ngritur në shoqëri.

1361. Pavarësisht kapitalit që ka familja, nëse fëmija nuk është i edukuar drejtë do ta humbas.

1362. Kur kuptojmë gjërat, mbesin një kohë të gjatë në ekranin e kujtesës sonë.

1363. Kapitali i madh, nganjëherë di ta çorientojë hapin e jetës.

1364. Përdorimi i dhunës apo dëmtimit fizik, nuk është hapi kyç për të ndaluar sjelljet e këqija të fëmijës, përkundrazi e inkurajon dhe më tepër.

1365. Shpërblejeni fëmijën, pas çdo pune të mirë, sepse vetëm atëherë e kupton që ka vepruar drejtë.

1366. Dy persona të dashuruar, sado që gjenden larg, kujtimet që kanë së bashku i bëjnë të afruar.

1367. Shpesh mundohem t'i nderoj e t'i dua të tjerët, por si ta dua atë që, kur më sheh, shpinën pas mua ma kthen.

1368. Edhe po të ishin, njëqind dashuri, dashurisë së parë asnjëra s'i ngjason.

1369. Nuk e dua një femër, që shkëlqen nga luku apo veshja, e veçanta e saj mbetet shkëlqesia në shpirt dhe zemër.

1370. Fatkeqësi nuk është të mos jesh i dashuruar, por kur nuk di të dashurosh.

1371. Dashurinë e sërishme, "provoje dhe njëherë" thoshte zemra.

1372. Dashuria rraptimë e fuqishme, "erozion gërryes" i zemrave.

1373. E si mund të kapërdijë zemra pikën e dhembjes, kur e di që s'të ka pranë.

1374. Dashuria është ajo llamba ndriçuese, që shpirtit tonë të errësuar i bën dritë.

1375. Dashuria është ajo etja e flaktë, që shpirtin e freskon.

1376. Dashuria është dhurata më e mirë, që ia ke bërë dikujt.

1377. Dashuria është ajo që edhe në terr të natës, të bën t'i hapësh sytë.
1378. Dashuria është ajo që edhe në pikë të vapës, çlodh njerëzinë.
1379. Dashuria është ëmbëlsia më e mirë, që t'i ia ke dhuruar vetes tënde.
1380. Mundohu që, sado pak, në zemrën e secilit, të lësh gjurmë të pashlyera.
1381. Singëriteti njihet në dashuri.
1382. Dashuria i jep botës shije. Po të mos kishte dashuri, bota do të ishte sikur një ushqim, tek i cili edhe pas ngrënies nuk ndjen shije.
1383. Mendja dhe zemra janë të afta të shprehin ndjenjat e dashurisë.
1384. Shpesh ta thyejnë shpirtin, vuan, të tundin kokën, por t'i prapë buzëqesh dhe trego se sa i fortë ndihesh përbrenda.
1385. Largësia s'i fsheh dot kujtimet e shpirtit, ato jetojnë deri në përjetësi.
1386. Dashuria është deti, ku çdo valë trazon kujtime.
1387. Dashurinë duhet ta kthesh në dashuri.
1388. Kur ke marrë dashuri, ke fituar çdo gjë. Kjo vlen edhe kur të japësh dashuri.

1389. Flori nuk është kur dashurohesh ndaj pasurisë, por drejt lumturisë.
1390. Dashuria është sikurse mëlmesa e ushqimit, kur i jep shije.
1391. Dashuri është frymëmarrja që s'ndalon së thëni :Të dua.
1392. Dashuria është e vetmja që na jep shtytje, edhe kur kemi dhjetëra halle e probleme të pazgjdhura.
1393. Një ditë, diku, do të të marr engjëllin e zemrës.
1394. Ndjenjat e mia të dashurisë, sillen rreth teje.
1395. Dashuria është ajo era e nxehtë kohëshkurtër, që shkrin ortek të tërë dëbore.
1396. Dashuria është shpirti i tronditur, që s'njeh përgjigje.
1397. Dashuria është fjala e pathënë e skalitur në zemër.
1398. Dashuri është kur natën gjumi nuk të zë, ndalesh hamendesh, nën hënën e plotë, ëndërron realitetin e kërkuar.
1399. Dashuri është lulja e vyshkur, që pret dorën të ta marrë, fletë e lagur nga lotët



që pret syrin ta lexojë, dhembjen, trishtimin, zjarrin, ngrohtësinë e vajtimin.

1400. Dashuri është të zhytesh në oazën e ëndrrave, të kujtimeve të pafundme që i sjell koha.

1401. Dashuria e vërtetë nuk duhet thyhet, sepse nuk ngjitet më.

1402. Dashuria, është njëlloj sikurse misri kur mbillet në arë, po nuk e punove apo ujite nuk sjell fryt

1403. Dashuri është paqja dhe hareja, kur dashurohesh me njeriun e qëlluar.

1404. Jorgan i tokës është dëbora, i njeriut dashuria.

1405. Dashuriadashurisë nuk i luan symbyllas.

1406. Buzëqeshja e shpirtit u jepet njerëzve të merituar.

1407. Kur dhimbja thërret mallin e ndarjes.

1408. Zemra ndihet e pasuruar, vetëm atëherë kur dashuron.

1409. Ai që lëkundet, nuk di të mbajë drejtpeshimin.

1410. Valët e jetës të mësojnë se si duhet notuar në kohë.

1411. Martesa që kurrë nuk ka zënka, është e shenjtë dhe e bekuar.
1412. Ndjenjat e mira janë ushqimi më i preferuar shpirtëror.
1413. Femrat e bukura nuk kanë nevojë për teletisje apo zbukurim të tepruar.
1414. Frika nga dështimi të lë në gjysmë të rrugës.
1415. Gjithnjë mundohu të gjesh arsye të arsyetueshme.
1416. Çdo njeri, me shprehi të mira pune, posedon njëfarë orari apo plan të punës.
1417. Dashuria është ndjenjë e përjetimeve tona personale, që mund të jenë përjetime të mira apo të këqija.
1418. Personalitetin tonë e pasqyrojnë qëndrimet, ndjenjat dhe motivet që kemi për rrethin.
1419. Për ta fituar dashurinë, së pari duhet të kesh mobilizim të fortë ndjenjash e energjie.
1420. Dashuria është njësoj si zjarri, edhe kur shuhet, hiri mbetet.
1421. Gjuha e dashurisë nuk ka nevojë për fjalë.
1422. Të mos duash, është sikur ta kalosh jetën bosh.

1423. Dashuri është të ringjalleth nga jeta.
1424. Vështirë është të kuptosh zemrën e atij që dashuron.
1425. Asgjë nuk di të jetë më embëlzuese se dashuria.
1426. Dashuria është ajo bashkëjetesa paqësore, që na sjell afri, dobi e përkujdesje.
1427. Dashuria është po ai burim energjie të pashterrshme që afron njerëzimin.
1428. Përgjegjshmëria, interesimi dhe fisnikëria na bëjnë ne të dashuruar.
1429. Dashuria është ajo që rrit imagjinatën, forcon karakterin dhe ngrit atributet e njeriut.
1430. Dashuria nuk heq dorë nga shpresa e besimi, ajo di të jetë e durueshme dhe e sjellshme.
1431. Dashurinë e karakterizon magjepsja dhe ekskluziviteti.
1432. Dashuria bashkëshortore krijon njerëzimin; miqësia e përsos, kurse dashuria e shfrenuar e prish dhe përul atë.
1433. Duke filluar në dashuri, mund edhe ta kuptojmë urrejtjen dhe gënjeshtren, nevojën e tyre për ta shquar të mirën.

1434. Xhelozia lind gjithmonë me dashurinë, por ajo gjithmonë nuk shuhet me dashurinë.

Të flasësh për dashurinë, është një një kënaqësi që e ndien, por ngërthen dhe një pjesë të njohurive në ligjërimin për dashurinë.

1435. Dashuria që është e krijuar në motive fisnike, zgjat përgjithmonë dhe na bën të bukur në realitet.

1436. Dashuri e madhe buron nga njohja e gjërave të dashura e të mëdha, dhe në qoftë se ju nuk i njihni ato, vështirë se dashuron.

1437. Sa shumë dashuri ka në një roman. Më shumë se në krejt një qytet!

1438. Kazanova, ky dashurues legjendar femrash, thoshte se dashuria është mbretëreshë e rinisë dhe tirani e pleqërisë.

1439. Ekziston koha për punë, por edhe koha për dashuri. Dhe nuk të[ lë hapësirë për një kohë tjetër.

1440. Të gjithë janë të lindur për dashuri, sepse ajo është parim i ekzistencës dhe qëllimi i saj i vetëm.

Prend BUZHALA:

E BUKURA SHFAQET PËR DITË  
DHE NË ÇDO  
*(Në vend të recensionit)*

Fjalët kanë shpirtin e tyre dhe bukurinë e tyre të thënies, fjalët klane fuqinë ta shprehin thellësisht e gjerësisht urtinë e jetës.

1.

Edhe i riu Fejz Demiri, e i ka ndjerë këtë bukuri të thënies së urtë, të ngjeshur e të shkurtër, të shqiptuar me saktësi e me elegancë. Ndoshta e pazakontë për moshën e një të riu të merret me thënien e shkurtët, me proverbin, aq më shumë për t'i krijuar ato, thjeshtësinë e saj, konkretësinë e shqiptimit të saj, për ta shprehur një të vërtetë.

Themi, e pazakontë, sepse kuptimi i proverbës a i thënies së urtë, kërkon dhe një përvojë të thellë jetësore. Kryesisht, të një përvoje të përbashkët brezash. Gjithsesi, Fejzi Demiri ka dëgjuar me vëmendje të vjetrit kur ata

ligjërojnë, ka dëgjuar urtinë e tyre nëpër oda burrash a mendimin e të tjerëve nëpër mjedise të tjera shoqërore, arsimore apo publike, duke vjelë me kujdes thënien dhe duke e sistemuar, dendësuar dhe shkruar në formën e thënies së shkurtër.

Sido që të jetë, nuk është e habitshme përse shpesh thënia e tillë, e gjendur në hapësirën e përvojës jetësore, ende të papërjetuar nga i riu; ajo do të merret si një udhëzues a parim që do ndjekur në jetë e në shoqëri, në familje a në përjetimet personale.

Nëse secila kulturë ka shembuj madhështorë të thënies së urtë, nuk është e habitshme përse edhe I riu Demiri, thith nga ato përvoja, nga shembujt e mëdhenj të jetës shoqërore, nga shembujt e mëdhenj të jetës ë s njerëzve të shquar, së këndejmi, dhe thënia e tij shpesh e shpesh, është një rikrijim i freskët i të dëgjuarës, i të përjetuarës nga të tjerët, i stisur në shkurtësi proverbiale.

Traditat e proverbës edhe te populli ynë kanë shekujt e mileniumet e tyre. Nuk ka popuj e kultura që nuk e ngërthejnë thënien e tillë. Dhe të shumtë janë autorët që e krijojnë dhe

rikrijojnë atë. Thënia e ndryshe quhet proverb, gnomë, sentencë, secila me nuancat e veta kuptimore-përcaktuese.

Madje, do të thoshim, se pikërisht fjala a thënia e urtë ka traditën më të gjatë letrare në botë.

Ato burojnë jo vetëm nga tradita gojore, po edhe nga letërsia, apo nga literatura e përgjithshme, qoftë ajo filozofike, historike, apo e fushave të tjera të dijes e të jetës. Proverbi a fjala e urtë dallon nga aforizmi, sepse ky i fundit ngërthen dhe aspektin satirik, anekdotik, qëndrimin kritik dhe ironik.

## 2.

Kohëve të fundit shpesh e shpesh na bie të lexojmë libra thëniesh e aforizmash, fjalësh të urta etj, të krijuara nga vetë autorët e këtyre librave ose të përmbledhura nga autorë të ndryshëm. Dikush e ka thënë se njeriu është vetë leximi, është njeriu që e gjen çelësin e teksteve të së kaluarës dhe i integron ato në bashkëkohësinë e tij Jo rrallë librat e aforizmave e të fjalëve të urta për bëjnë një ndërliçësi edhe nga aspekti i zhanrit. E pra, kemi të bëjmë me

shkrimin e me endëzimin e një libri të ri, që nuk është interpretim. Kurse jo rrallë librat e tillë qëndrojnë midis "krijimit" dhe "interpretimit". Në të gjithë librat e shenjtë të të gjitha religjioneve botërore, ekzistojnë madje jo vetëm thënie të përveçuara, që përdoren në trajtën e dijes a të urtisë, por ekzistojnë edhe libra të tillë të tërë, sikundër ekzistojnë te Besëlidhja e Vjetër, bie fjala, Libri i Fjalëve të Urta, Libri i Urtisë etj e që i mbajnë si autorë më urtët, Solomonin, Agurin e Lamuelin, librat e të cilëve nuk mbaheshin vetëm “në nivelin e dijes e të urtësisë njerëzore, po edhe të përmbajtjes që merr kuptim religjioz e moral shumë të thellë.”

3.

Thënia e shkurtër e këtij vëllimi përmban sentenca dhe proverba të mirëfillta, të shkoqitura me kujdes, me saktësi e të formuluar saktë, përmban mendime eseistike të shkurta për problematika të ndryshme të jetës dhe shoqërisë, njeriut dhe botës shpirtërore, por përmban dhe tekste të mirëfillta lirike, sidomos ato mbi dashurinë, që



hyjnë në dy zona kuptimore, në atë të proverbit dhe në atë të metaforizmit lirik të dashurisë.

Dihet se jo çdo fjali e shkurtër a e folur është proverb, sepse ato duhet të ngërthejnë një urti, një mendim dh një shqiptim të mençurisë, ngërthejnë një poentë për të vërtetën, moralin, dhe një metaforikë efikase. Ajo ngërthen përvojën e memories së brezave... Nëse ka ndonjë idiomë gjuhësore autoriale, refleks nga ligjërimet popullore, atherë ajo merr pamjen e thënies së urtë brenda tërësisë së librit.

Vërtet, thëniet e urta proverbiale i hasim në shumë poezi, duke e thurur vargun aforistik, dhe këso vargjesh aforistike nuk janë të pakta edhe te ky vëllim. Fjalën e tillë e takojmë, si thënie, te ndonjë personazh në roman, në dramë, në teatër a në film. Pra, ka përdorim të gjerë në shumë fusha të artit e të kulturës.

Porse ky vëllim ka vlerën e vet, përpjekjet e pareshtura, që vetë autori ta formulojë mendimin e urtë e të shkurtë.

Synimi i autorit të ri, për ta botuar një libër thëniesh të tilla, ka dhe një vlerë tjetër. Ka vlerë pikërisht për arsyen e thjeshtë, se thënia e tillë synon majat më të larta të të jetuarit e të

përjetuarit. Synon përsosmërinë e qenies njerëzore, harmoninë familjare e atë mes njerëzve, popujve, madje edhe armiqve. Synon të jetë një doracak udhërrëfyes në jetën e një njeriu. Synon majat e mendimit, jetës së pasur shpirtërore e etiko-morale. E bukura dhe dashuria, e drejta dhe e vërteta, harmonia dhe demaskimi i të keqes, përbëjnë pjesë meditimesh të pasura të këtij vëllimi. Mbi të gjitha, synon bukurinë e thënies. Dhe këtij qëllimi ky vëllim ia arrin me sukses.

## SHËNIME PËR AUTORIN

Fejz Demiri është nga fshati Stubëll i Gjakovë. U lind më 15 janar 1997 në Gjakovë.

Shkollën fillore e kreu në SHFMU “Bajram Sadriu” në Berjahë.

Ndërsa të mesmen, shkenca natyrore –gjimnaz, e kreu në Gjakovë.

Tani është student i vitit të parë në Universitetin “FAMA” në Prishtinë, në degën e psikologjisë.

Kur ishte fillorist dhe gjimnazist, ka botuar dy përmbledhje poetike:

1. Vargje përkushtuese, vëllimi i parë, 2012 dhe
2. Vargje përkushtuese, vëllimi i dytë, 2014.

Ky është libri i tretë i tij, kurse i pari me thënie e mendime të tilla.

## PËRMBAJTJA

Fjalë të urta dhe mendime autoriale, 5 – 132

Prend Buzhala: E bukura shfaqet për ditë, dhe në çdo kohë (Në vend të recensionit), 133

Shënime për autorin, 139